




# Bankieri

Botim Nr. 31  
Prill 2019

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



## NDËRHJRJA E JASHTËZAKONSHME NË BANKA



3<sup>rd</sup> CONFERENCE  
14 MAY 2019

# Banks for Sustainable Development



SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

## ANËTARËT E AAB-së



## PËRMBAJTJA

## Bankieri

Nr.31, Prill 2019

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave



## REDAKSIA:

Elvin Meka

**Kryeredaktor**

Eftali Peçi

**Koordinatorë Produksioni**

Junida Tafaj (Katroshti)

**Bashkëpunëtore**

Dorina Zarka

**Fotografe****Design & Layout:** FCB AfirmaShtypi nga:  Gent-grafik

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. Bankieri i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

## SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. Ibrahim Rugova,

SKY TOWER, 9/3, Tiranë

Tel: +355 4 2280371/2

Fax: +355 4 2280 359

www.aab.al

**Speciale**

20 vjet AAB

Spiro BRUMBULLI

4

**Editorial**

Ndërhyrja e jashtëzakonshme në banka - Për një sektor bankar të shëndetshëm e të qëndrueshëm

Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA

7

**Tema e Ditës**

Ndërhyrja e jashtëzakonshme në banka në Shqipëri - me ritmin e Evropës

Natasha AHMETAJ

8

Rimëkëmbja dhe ndërhyrja e jashtëzakonshme në banka në Evropë - Shtylla e dytë e Unionit Bankar

Denada PRIFTI

11

**Sistemi Bankar**

SNRF 9 një vit më pas

Dr.Hergis JICA

15

Raporti i vlerësimit të MONEYVAL plane dhe veprime - Për një luftë më efektive ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Arind GJOKUTA

16

**Forumi i Ekspertëve**

Letrat me vlerë private: Ku është sipërmarrja shqiptare?

Blodin ÇUÇI

19

Ndikimi i kërkesave të raportimit në huadhënien e bankave

Prof. Dr. Hysen ÇELA, CA, CPA

21

PSD2 Open Banking: Çfarë duhet të dinë bankat!

Klodjan HIMA

23

Rritja e agrobiznesit, një mundësi e re për rritjen e financimit të sektorit privat nga bankat tregtare

Gramos OSMANI

25

Komunikimi - Një rikujtesë për audituesit e brendshëm

Stavri PASHKO

26

**Auditori Financiar**

CoCo Bonds - Obligacionet e veçanta, për situata të veçanta

Prof. Asoc. Dr. Arbi AGALLIU

29

**Zhvillime të Reja**

Standardi 2.0 EMV 3D-Secure - Blerje të Sigurta Online

Akil NDRENIKA

31

**Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm**

32

**Java e Parasë**

36

**AAB: Aktivitete - Trajtime**

43

**BORDI EDITORIAL:**

Silvio PEDRAZZI

Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së &amp; Drejtor i Përgjithshëm, Intesa Sanpaolo Bank Albania

Dritan MUSTAFA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së &amp; Drejtor i Përgjithshëm, Tirana Bank

Ervin KOÇI

Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

Adela LEKA

Nënkryetare e Bordit Drejtues të AAB-së &amp; Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive, Procredit Bank

Andi BALLTA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së &amp; Drejtor i Përgjithshëm, American Bank of Investments

Adrian CIVICI

President i Universitetit Europian të Tiranës

Hysen ÇELA

Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Maltin KORKUTI

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së &amp; Drejtor i Përgjithshëm, Credins Bank

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së &amp; Drejtor i Përgjithshëm, Fibank Shqipëri

Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave

# 20 vjet AAB

*Duke përfaqësuar industrinë më të shëndoshë dhe më krenare të ekonomisë, duke promovuar standardet më të fundit bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), në partneritet me aktorët e sektorit publik dhe privat, kontribuon për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të diskutuar çështjet kyçe të industrisë, si dhe përcaktimin e strategjive të përbashkëta për sektorin financiar shqiptar.*



## Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

**20** vjet AAB! Vitet ikin shpejt. Nga ideja e një Klubi të Bankierëve, e diskutuar gjatë viteve 1997 – 1998 dhe krijimit të tij në mars të vitit 1999 në kalimin shumë shpejt, vetëm 2 vjet më pas, te Shoqata Shqiptare e Bankave – një organizatë jo fitimprurëse, e ngritur si kërkesë e fortë e problematikave të kohës. Ishte koha e ngritjes së bankingut, e formësimit të tregut, e konturimit të tij, e uljes së peshës specifike të bankave shtetërore, e rritjes së sektorit privat, e nevojës së shëndoshjes së sistemit financiar, pas kohës së piramidave financiare; e zhvillimit të ekonomisë ku bankat janë pjesë dhe faktor i pandarë i

zhvillimit dhe rritjes ekonomike. Ishte koha kur ndryshime ligjore ishin të domosdoshme, ku standardet e reja duhet të përshtateshin dhe tregu të trajnohej dhe mësohej me një mënyrë të re të bërjes biznes, të trajtimit të sektorit privat, të dedikimit, përkushtimit, ndershmërisë, integritetit, emrit të mirë. Kishte ardhur momenti që bankat të ndihmonin të tjerët dhe të



AAB është pjesë e çdo tavoline ku diskutohen projektligje, projektrregullore, projekte zhvillimore, paraqiten ide dhe propozime. Prestigji i AAB-së është i padiskutueshëm, ashtu sikundër vizibiliteti i saj është rritur me organizimin e veprimtarive, si: konferenca, forume, tryeza diskutimi dhe pjesëmarrje në media

ndihmonin veten.

E themeluar në një mjedis ekonomik të brishtë, me plot pasiguri, sfida dhe optimizëm, pritsmëritë nga AAB nuk ishin të pakta. Vitet e para, në mungesë të eksperiencës dhe të angazhimit maksimal të të gjithë anëtarëve, AAB duhet të bindte çdo skeptik se ky organizim ka vlerë për të përfaqësuar bankat

në një zë, për të mbrojtur të drejtat e veta dhe për të promovuar standardet më të përparuara. Me privatizimin e bankës së fundit shtetërore në vitin 2004, roli, dobia dhe funksioni i AAB-së u bë më se evident. Ishte pikërisht kjo arsyeja që, në vitin 2005, Sekretariati i AAB strukturohet sipas modeleve më të përparuara të vendeve të tjera të zhvilluara, me të cilat AAB pati fat të krijonte lidhje e kontakte që në vitin 2003, kur u pranua si Anëtare e Asociuar e Federatës Bankare Europiane, EBF.

Periodha 2005 – 2009 ka qenë një periudhë e boom-it në huadhënie. Rritje të tilla nuk ishin parë kurrë më parë në ekonominë shqiptare. Në mungesë të saktësimeve të titujve të pronësisë, të kuadrit ligjor me mangësi, të infrastrukturës pak të zhvilluar dhe të numrit të pakët të popullsisë si llogari-mbajtës pranë një banke, falë pranisë së bankave të mirënjohura ndërkombëtarisht, AAB duhej të mbështeste fort rregullimin e tregut, në bazë të një situatë të re të krijuar në treg me banka tërësisht private. Eksperienca e fituar në këto vite ishte e rëndësishme të përdorej dhe pasurohej në vitet që do të pasonin, të cilat nuk ishin më aq të lumtura. Kriza e viteve 2008 – 2009 nuk mund ta linte ekonominë shqiptare të paprekur, edhe pse vala erdhi disi me vonesë, pas vitit 2010. Shenja më e egër ishte mos shlyerja e kësteve të huave, duke rritur portofolin e huave me



probleme. Bankat, duke evidentuar rreziqet dhe llogaritur efektin e tyre, u bënë më përzgjedhëse dhe më të shtrënguara në analizën e tyre të rrezikut. Kjo periudhë u shoqërua me shumë ndryshime rregullative dhe ligjore, ku emri “bankë” nuk ngjallte më të njëjtin respekt, si para krizës. Imazhi i bankave në vendet ku kriza filloi, preku kudo në botë emrin “bankier”. Rifitimi i imazhit dhe besimit ishte një proces i vështirë. U shtuan kërkesat rregullative për shëndoshjen e bankave, u rritën kërkesat për kapital, për kontroll dhe transparencë. Është kjo periudhë kur AAB vendosi të publikojë revistën e saj periodike tre mujore “Bankieri” (tetor 2011). Çfarëdo që ndodhi me krizën në botë, u bë e qartë se bankat shqiptare nuk krijuan kurrsesi krizë në ekonomi, nuk kërkuar asnjë mbështetje buxhetore, nuk morën asnjë ndihmë, por aksionarët përmbushën çdo kërkesë për plotësim të kapitalit, duke ndihmuar kështu në rivendosjen e imazhit dhe emrit të mirë – proces që vazhdon me profesionalizëm dhe durim.

Interesant mbetet fakti se, në kuadrin e strategjisë së rifitimit të emrit të mirë dhe zbatimit të praktikave më të mira bashkëkohore të qeverisjes së korporatave, bankat zhvilluan si kurrë më parë përgjegjësinë sociale të korporatave, duke nënkuptuar se roli i tyre i rëndësishëm në ekonomi si ndërmjetës financiar nuk mund të ishte i plotë pa rolin plotësues në shoqëri. Në përgjigje të kësaj dukurie të re, për herë të parë në vitin 2015, u botua raporti vjetor “CSR - Bankat për Shoqërinë”, që i kushtohet kontributit të bankave në shoqëri. Kjo strategji e re u shoqërua me zgjerimin, përkrahjen, mbështetjen dhe vizionin e ri që krijojnë Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, të vitit 2015.

Pas krizës ndërkombëtare, lindi nevoja e trajnimit të stafit të bankave, jo vetëm nëpërmjet burimeve të brendshme të çdo banke, por edhe të trajnimeve të përbashkëta me kosto më të ulët. Që nga viti 2011, AAB ka zhvilluar 204 trajnime, ku janë trajnuar mbi 2,655 punonjës banke. Për herë të parë në vitin 2018 u ofruan dy trajnime on-line për 215 punonjës.

Kështu, me kalimin e viteve misioni i AAB-së po pasurohej, po zgjerohej dhe po fitonte besueshmëri të shtuar. Që nga viti 2013, AAB përqafoi fort idenë e Bankës së Shqipërisë për edukimin financiar,



...AAB, në partneritet me aktorët e sektorit publik dhe privat, kontribuon për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të diskutuar çështjet kyçe të industrisë dhe përcaktimin e strategjive të përbashkëta për sektorin financiar shqiptar.



në mënyrë që të rritej përdorimi i kanaleve financiare nga popullsia. Në mënyrë të vazhdueshme, AAB organizon Javën e Parasë dhe veprimtari gjatë vitit me nxënës të shkollave dhe studentë, për t'u njohur me koncepte financiare bazë dhe të përparuara.

AAB është pjesë e çdo tavoline ku diskutohen projektligje, projektregullore, projekte zhvillimore, paraqiten ide dhe propozime. Prestigji i AAB-së është i padiskutueshëm, ashtu sikundër vizibiliteti i saj është rritur me organizimin e veprimtarive, si: konferenca, forume, tryeza diskutimi dhe pjesëmarrje në media.

Duke përfaqësuar industrinë

më të shëndoshë dhe më krenare të ekonomisë, duke promovuar standardet më të fundit bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, AAB, në partneritet me aktorët e sektorit publik dhe privat, kontribuon për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të diskutuar çështjet kyçe të industrisë, si dhe përcaktimin e strategjive të përbashkëta për sektorin financiar shqiptar.

Njëzet vite nuk janë shumë, por nuk janë dhe pak. Duke u kthyer pas në vite dhe analizuar procesin e rritjes në pikën ku jemi sot, vërejmë një proces që ka pasur dhimbjet dhe vështirësitë e veta. Si çdo rritje, përtej vështirësive, të gëzon stadi i arritjeve. Falë kontributit edhe të kryetarëve në vite, si: Seyhan Pencabligil, Christian Canacaris, Periklis Drougkas, Ardian Fullani, Edvin Libohova, Gazmend Kadriu, Libero Catalano, Giancarlo Rizzola dhe kryetarit aktual Silvio Pedrazzi, AAB është sot një nga organizatat jofitimprurëse më të organizuara, më të strukturuar dhe më profesionale. Sot ne ndihemi krenarë dhe gjithë industria bankare ndihet krenare, sepse ndihet e përfaqësuar, e shërbyer dhe e vlerësuar.

Në këtë përvjetor, një falenderim i veçantë shkon për të gjithë bashkëpunëtorët tanë, brenda dhe jashtë vendit, për marrëdhëniet e shkëlqyera të bashkëpunimit, seriozitetit dhe përgjegjësisë së manifestuar në vite. Falenderim, gjithashtu, për të gjithë anëtarët e komiteteve teknike të AAB-së, pa ekspertizën e të cilëve do të ishte i vakët kontributi i AAB-së.

20 vjet! Dhe është gjithnjë e njëjta dilemë. Në çdo përvjetor: Mirë deri tani, po më tej?

Le të ndjekim traditën tonë të mirë e të urojmë: Gëzuar, AAB!

Paç jetën e gjatë! Suksese!

# KARTA E KREDITIT CONTACTLESS NJE KARTE PER TE GJITHE



**0 komision** për blerjet në POS & Internet, brenda & jashtë Shqipërisë  
**0 komision** mirëmbajtje për vitin e parë  
**0% Interes** për pagesë të plotë të faturave mujore  
Deri në **45 ditë** kohë për të shlyer detyrimin minimal të kartës, **5%** të shpenzimeve mujore  
**NJE BOTE MUNDËSISH REALE.**



 **INTESA SANPAOLO BANK**  
Albania

    [www.intesasanpaolobank.al](http://www.intesasanpaolobank.al)

CALL CENTER  
08006000 (Falas nga Albtelecom & Eagle) +355 4 2276000, +355 692080903

Ky është një publikim reklamues, për Kushtet e plota të Punës dhe normat e interesit vizitoni cilëndo prej degëve tona, klikoni website të Bankës ose na telefononi në Shërbimin tonë Call Center.

Bankë e **INTESA**  **SANPAOLO**

# Ndërhyrja e jashtëzakonshme në banka

## Për një sektor bankar të shëndetshëm e të qëndrueshëm

*Shqipëria ka shënuar progres të ndjeshëm dhe është në pararojë të reformave financiare në vendet e rajonit, e kjo jo në kuadër të ndonjë detyrimi specifik që ka Shqipëria, por në përmbushje të objektivit ambicioz të sigurimit të një sektori bankar kombëtar të sigurt e të qëndrueshëm.*



**Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA<sup>1</sup>**  
Kryeredaktor

**K**riza ekonomike dhe financiare globale e vitit 2008 shënon momentin kulmor të shfaqjes së dobësive dhe mangësive të rëndësishme në kuadrin ligjor dhe institucional që rregullonte sektorin bankar, e më gjerë, sistemin financiar global, por dhe në rrafsh kombëtar, kryesisht në SHBA dhe vendet e BE-së, e jo vetëm. Këto mangësi theksuan edhe më shumë faktin se rregullatorët kishin bërë shumë pak për shmangien e dëmit moral të shoqërizimit të humbjeve dhe privatizimit të fitimeve. Pra sfida nuk ishte kapërcimi i krizës financiare, por kapërcimi i saj me sukses, me sa më pak kosto për stabilitetin financiar dhe ekonominë reale të një vendi, pa përdorur paratë e taksapaguesve. Konkretisht, kapërcimi i krizës financiare globale,

duke përdorur fonde publike, rriti ndërgjegjësimin dhe nxiti aktorë të ndryshëm të tregut financiar për të reformuar dhe rregulluar procesin e ristrukturimit dhe nxjerrjes së bankave nga vështirësia financiare, duke i kanalizuar humbjet së pari drejt aksionarëve, e më pas, drejt kreditorëve të bankës. Ky proces, i cili njihet sot me termin: “ndërhyrje e jashtëzakonshme”, e ka zanafillën e tij pikërisht në periudhën e post-krizës së viteve 2007-2008.

Procesi i reformave të sektorit financiar filloi në SHBA, për vet faktin se ato u përballën të parat me krizën e gjeneruar nga sistemi financiar amerikan dhe arriti kulmin me miratimin e Ligjit Dodd-Frank në vitin 2010. Ky ligj solli ndryshime në mjedisin financiar amerikan, që u pasqyruan në një varg agjencish rregullatore financiare, e thuajse në çdo pjesë të industrisë së shërbimeve financiare. Në Europë, ky proces kulmoi me miratimin e Direktivës për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka (BRRD), themelimin e institucionit europian përgjegjës për realizimin e këtij procesi - Bordi i Përbashkët i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (SRB) – dhe miratimin e një sërë dokumenteve rregullative, apo standardesh teknike, që plotësojnë kornizën rregullatore për realizimin me sukses të këtij procesi.

Shqipëria nuk mund të rrinte prapa reformave të ndërmarra nga sektori financiar europian. Në vijim të këtyre reformave dhe me

mbështetje të Bankës Botërore, në fund të muajit dhjetor të vitit 2016, Kuvendi miratoi Ligjin nr.133/2016: “Mbi rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”, i cili hyri në fuqi në korrik të vitit 2017. Megjithatë më pak se dy vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Shqipëria ka shënuar progres të ndjeshëm dhe është në pararojë të reformave financiare në vendet e rajonit, e kjo jo në kuadër të ndonjë detyrimi specifik që ka Shqipëria, por në përmbushje të objektivit ambicioz të sigurimit të një sektori bankar kombëtar të sigurt e të qëndrueshëm.

Aktualisht, Banka e Shqipërisë, në rolin e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, ka ngritur infrastrukturën përkatëse rregullatore dhe institucionale për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në bankat që operojnë në vend. Por, ky është vetëm fillimi. Eksperienca ndërkombëtare ka treguar që rruga për të realizuar një ndërhyrje të jashtëzakonshme të suksesshme është e gjatë dhe e vështirë, ashtu siç shprehet edhe drejtuesja e Bordit të Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Zj. Elke König: “...planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk është një “sprint”, por një “maratonë”!

<sup>1</sup>Zv.Rektor, Universiteti Europian i Tiranës, UET

# Ndërhyrja e jashtëzakonshme në banka në Shqipëri - me ritmin e Evropës

*Planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme është një proces i vazhdueshëm dhe një mision afatgjatë, për heqjen e pengesave ndaj mundësisë për ndërhyrje në bankë dhe nuk nënkupton hartimin e një plani vjetor, që ruhet diku në një raft dhe shpluhurohet vetëm në rast nevojë për zbatimin e tij, por përbën fillimin e një procesi të gjatë të ristrukturimit të gjithë aspekteve të biznesit bankar, që mund të pengojnë këtë proces.*



**Natasha AHMETAJ**

Zëvendës Guvernator  
BANKA E SHQIPËRISË

**M**odeli i integritimit global është model i ekonomik që ka ndjekur edhe shumica e vendeve në tranzicion, sikurse dhe Shqipëria. Nën këtë orientim, tregu bankar shqiptar ka dëshmuar vullnet dhe objektivitet të qarta, për një integritet sa më të shpejtë në kuadrin ligjor të sistemit bankar të Bashkimit Evropian, si dhe të ndryshimeve të rëndësishme që ai ka pësuar pas vitit 2008. Megjithatë në historinë e sektorit bankar shqiptar, fatmirësisht nuk ka raste të falimentimit të bankave, ne e vërtetojmë të njëjtat boshllëqe në legjislacionin tonë bankar, sikurse edhe ekonomitë e tjera evropiane. Duke ndërtuar skenarët hipotetikë për përballimin e një ekspozimi potencial të ekonomisë shqiptare ndaj krizës së borxhit

sovrani grek, u evidentua se, Banka e Shqipërisë, si autoriteti mbikëqyrës për sektorin bankar, nuk i kishte të gjithë instrumentet e duhura ligjore, për menaxhimin e situatave të paafësisë paguese në bankat me rëndësi sistemike. Kjo nevojë, për një kuadër të ri ligjor evidentohet në të gjitha aspektet, ato kombëtare dhe ndërkufitare, nga Direktiva Evropiane për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në banka. Në fakt, përpjekjet fillestare për përgatitjen dhe paraqitjen e planeve të para të rimëkëmbjes pranë Bankës së Shqipërisë, e kanë zanafillën në vitin 2012. Udhëzuesi përkatës u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në vitin 2014, por natyrisht, këto ishin përpjekje brenda autoritetit ligjor mbikëqyrës, e si të tilla, ishin të pamjaftueshme. Për këtë arsye, gjatë vitit 2015, me mbështetjen e projektit FinSac të Bankës Botërore, Banka e Shqipërisë filloi punën e vështirë, por të domosdoshme, të harmonizimit me Direktivën Evropiane, nëpërmjet një ligji të ri shqiptar.

Ligji: "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë" hyri në fuqi në korrik 2017, duke i atribuuar Bankës së Shqipërisë mandatin e ri të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në banka. Ky mandat plotëson mekanizmin e plotë të sigurisë financiare për sektorin bankar, me Bankën e Shqipërisë si përgjegjëse

për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit bankar, hartimin e politikave makroprudenciale, kryerjen e funksionit të huadhënësit të fundit, si dhe zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Së bashku me skemën e mbulimit të depozitave, të ofruar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave që prej vitit 2002, kuadri i sigurisë financiare në Shqipëri është i plotë. Në zbatim të këtij ligji, u krijua dhe Fondi për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, me kontribut të sektorit bankar. Ky fond synon të arrijë nivelin 6.3 miliardë lekë, brenda vitit 2027.

Procesi i zbatimit të ligjit shqiptar të rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme përfshin tri hapa të rëndësishëm:

**Hapi i parë** është hartimi i planeve të rimëkëmbjes, nga secila bankë që vepron në Shqipëri, me skenarë të besueshëm e konkretë, si dhe përcaktimi i treguesve sinjalizues që paralajmërojnë përkeqësimin e situatës financiare në bankë, përpara se ajo të jetë në vështirësi të parikuperueshme. Gjatë hartimit të planeve të rimëkëmbjes, banka duhet të krijojë opsione të besueshme, për të mbijetuar ndaj skenarëve të stresit, duke ngritur në këtë mënyrë mekanizma që bëhen pjesë e menaxhimit ditor të biznesit bankar dhe nuk mbeten thjesht pjesë e një plani hipotetik. Pavarësisht se hartimi i planeve të rimëkëmbjes është detyrë e bankave individuale, Banka e Shqipërisë, në cilësinë e



Autoritetit Mbikëqyrës, luan një rol thelbësor në vlerësimin e cilësisë dhe besueshmërisë së këtyre planeve.

Gjatë vitit 2018, bankat hartuan planet e rimëkëmbjes, bazuar në një akt të ri nënligjor të miratuar nga Banka e Shqipërisë, që përcakton përmbajtjen e detajuar të tyre. Duket theksuar se, sfidat tona mbeten të njëjta me ato me të cilat përballen edhe autoritete të tjera mbikëqyrëse në këtë fushë, qofshin ato evropiane apo të rajonit.

Në situata të qëndrueshme financiare, planifikimi i rimëkëmbjes i mundëson Bankës së Shqipërisë njohjen e thellë të strukturës dhe operacioneve të bankës, duke mbështetur në këtë mënyrë procesin tonë të mbikëqyrjes drejt identifikimit të fushave për përmirësim, si dhe vet-diagnostikimin e bankës për këto fusha. Në situata të vështira financiare, plani i rimëkëmbjes është dokumenti kryesor që ka banka në dorë, për korrigjimin e vështirësive të saj, e si i tillë, duhet të jetë eficient, i zbatueshëm dhe gjithëpërfshirës.

**Hapi i dytë** i kuadrit të ri të menaxhimit të krizave, lidhet me ndërhyrjen e hershme në bankë. Ky hap aktivizohet në rast se, pas zbatimit të planeve të rimëkëmbjes, veprimet e bankës nuk rezultojnë të suksesshme për përmirësimin e situatës. Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes, ndërmerret disa masa konkrete të ndërhyrjes së hershme në bankë, përpara se banka të shfaqë paaftësi paguese. Aktualisht ne jemi në procesin e hartimit të akteve nënligjore, që përcaktojnë mënyrën e zbatimit të ndërhyrjes së hershme, sipas kërkesave të reja ligjore.

**Hapi i tretë** në menaxhimin e krizave është ndërhyrja e jashtëzakonshme në bankë, që kryhet nga Banka e Shqipërisë, në cilësinë e mandatit të ri që ka marrë. Në mënyrë të ngjashme

me planet e rimëkëmbjes, planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që hartohen nga Banka e Shqipërisë, synojnë të identifikojnë pengesat ligjore, strukturore dhe të burimeve financiare që ka banka, ndaj mundësisë për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në këtë drejtim, planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë një nga mjetet thelbësore për lehtësimin e zbatimit të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë.



Plotësimi i MREL paraqet një sfidë për vende si Shqipëria, për shkak të kapacitetit të tregut vendas për të përthithur (blerë dhe mbajtur) borxhin e varur, që mund të shërbejë për plotësimin e kërkesës minimale si dhe të kapacitetit të vetë bankave për ristrukturimin e burimeve të financimit, të cilat përbëhen aktualisht, në një masë të gjerë, nga depozitat.



Në muajin prill të këtijviti, Banka e Shqipërisë miratoi aktin nënligjor që përcakton përmbajtjen e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në vijim, bankave iu kërkua të raportojnë një tërësi të dhënash për hartimin e këtyre planeve, bazuar në modelin e Autoritetit Bankar Evropian dhe aktualisht jemi në proces të hartimit të këtyre planeve. Hartimi i planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka është i komplikuar, përfshin fusha të natyrave mjaft komplekse e ndërkufitare, të cilat duhet të zbatohen dhe koordinohen brenda një periudhë të shkurtër kohore. Në këtë perspektivë, planifikimi i

ndërhyrjes së jashtëzakonshme është një proces i vazhdueshëm dhe një mision afatgjatë, për heqjen e pengesave ndaj mundësisë për ndërhyrje në bankë. Ky planifikim nuk nënkupton hartimin e një plani vjetor, që ruhet diku në një raft dhe shpluhurohet vetëm në rast nevojë për zbatimin e tij, por përbën fillimin e një procesi të gjatë të ristrukturimit të gjithë aspekteve të biznesit bankar, që mund të pengojnë këtë proces. Këndvështrimi ynë është se ky proces i përket po aq Bankës së Shqipërisë, si Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, sa edhe bankave që duhet të përfshijnë rezultatet e tij në veprimtarinë e përditshme të biznesit të tyre.

Gjatë ciklit të parë të kësaj pune për vitin 2018, kemi evidentuar një sërë çështjesh që kërkojnë vëmendje të veçantë në plan, por edhe në ndjekjen e tyre nga bankat:

- Banka e Shqipërisë duhet të ketë qasje në një nivel sa më cilësor të informacionit të prodhuar nga bankat, me qëllim përzgjedhjen e duhur të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- Identifikimi i saktë i sistemeve operacionale të bankës, të ndërlydhura me funksionet kritike, është i rëndësishëm;
- Njohja e mirë e marrëveshjeve kontraktuale dhe trajtimi përkatës i tyre është domosdoshmëri; dhe veçanërisht,
- Sigurimi i burimeve të financimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme përbën sfidë.

Plotësimi i Kërkesës Minimale për Kapital dhe Detyrime të pranuar, apo që njihet si MREL, ku mbështetet pikërisht aplikimi i instrumentit esencial të ri të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ai i rikapitalizimit nga brenda, apo bail-in, mbetet sfida kryesore për periudhën afatmesme. Plotësimi i MREL paraqet një sfidë

për vende si Shqipëria, për shkak të kapacitetit të tregut vendas për të përthithur (blerë dhe mbajtur) borxhin e varur, që mund të shërbejë për plotësimin e kërkesës minimale si dhe të kapacitetit të vet bankave për ristrukturimin e burimeve të financimit, të cilat përbëhen aktualisht në një masë të gjerë nga depozitat. Rrjedhimisht, për përmbushjen e këtij detyrimi duhet projektuar një periudhë e ndërmjetme, pa cenuar në asnjë rast synimin kryesor të zbatueshmërisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.


Së fundi, ndërhyrja e jashtëzakonshme është një proces mjaft sfidues për vendet në zhvillim dhe ato të zhvilluara. Sektori bankar në Ballkan mbizotërohet nga bankat me kapital të huaj. Në Shqipëri, filialet e bankave me kapital të huaj përbëjnë rreth 78% të aktiveve të sektorit bankar, ndërsa ato evropiane 48%. Banka e Shqipërisë është Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme

për 7 filiale të grupeve bankare të Bashkimit Evropian, 4 prej të cilave të klasifikuar si sistemike, nën mandatin e Bordit të Përbashkët për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, SRB. Për këtë qëllim, nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të grupit bankar dhe autoriteteve lokale ku vepron filiali, është mjaft i rëndësishëm për koordinimin e veprimeve, shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe në tërësi për menaxhimin e koordinuar të krizave. Banka e Shqipërisë është e para në rajon që ka nënshkruar marrëveshjen e rëndësishme të bashkëpunimit me Bordin e Përbashkët për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, pra Autoritetin e Ndërhyrjes për Bashkimin Evropian, më 3 tetor 2018.

Konferenca e organizuar në bashkëpunim me Bankën Botërore

në nëntor të vitit të kaluar, kulmoi punën e deritashme të Bankës së Shqipërisë, në mandatin e ri si autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, duke certifikuar njëkohësisht pjekurinë e hapave të hedhur drejt zhvillimit të një kuadri të plotë për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në sektorin bankar. Pjesëmarrja aktive në këtë konferencë e kolegëve nga Autoritetet e Mbikëqyrjes dhe të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në nivel qendror të Bashkimit Evropian, nga Autoritetet Kombëtare të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme të disa vendeve të Bashkimit Evropian dhe të rajonit, bankierë vendas dhe të huaj, si dhe përfaqësues të mediave, u përkthye në shkëmbim eksperiencash dhe në një urë të re, për bashkërendimin e përpjekjeve tona për një sistem të qëndrueshëm financiar, brenda dhe jashtë kufijve gjeografikë.

### Tri hapat e procesit të zbatimit të ligjit shqiptar të rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme.



# Rimëkëmbja dhe ndërhyrja e jashtëzakonshme në banka në Evropë

## Shtylla e dytë e Unionit Bankar



### Denada PRIFTI

Senior Manager në SRB, përgjegjëse për banka të rëndësishme në Gjermani, Maltë dhe vendet baltike  
GJERMANI, VENDET BALTIKE

Tashmë kanë kaluar mbi dhjetë vjet që nga momenti kur sistemi financiar botëror përjetoj një prej krizave më të rënda, që nga Lufta e Dytë Botërore. Kriza e shkaktuar nga shpërthimi i tregut amerikan të huave për klientët jociësorë, u transformua shpejt në një krizë më të gjerë financiare dhe të borxheve sovraane. Në kuadër të masave urgjente, të parashikuara për të zbutur rreziqet e falimentimit të institucioneve financiare, që do të çonin në pasojë edhe më të mëdha negative në stabilitetin financiar dhe në ekonominë reale, disa qeveri evropiane ofruan fonde shpëtimi (injektim fondesh dhe dhënie garancish publike), për të mbuluar humbjet e shkaktuara dhe

rikapitalizuar institucionet financiare. Shuma e përgjithshme e ndihmës shtetërore arriti në 671 miliardë euro në fonde likuide dhe hua, si dhe 1,288 miliardë euro në formë garancish, gjatë periudhës 2007-2014<sup>1</sup>. Kriza çoi në fragmentim (duke u fokusuar kryesisht në tregjet e brendshme), humbje të besueshmërisë dhe besimit të publikut në sektorin financiar dhe në përdorimin e shumave të mëdha nga paratë e taksapaguesve për të shpëtuar institucionet financiare në vështirësi.

**1. Mekanizmi i Përbashkët i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, si një nga tre shtyllat e Unionit Bankar Evropian - Pak histori dhe zhvillimet kryesore deri më sot.**

Si rezultat i mësimëve të nxjerra gjatë krizës, në vitin 2012 Komisioni Evropian hartoi një plan për krijimin e Unionit Bankar (UB) dhe Librit të Rregullave të Përbashkëta. Qëllimi ishte sigurimi i kërkesave prudenciale më të forta për bankat, vendosja e rregullave për bankat që falimentonin dhe përmirësimi i mbrojtjes së depozituesve. Libri i Rregullave të Përbashkëta përbën kuadrin rregullator, ndërkohë UB është struktura institucionale, e përbërë nga tre shtylla: 1) Mekanizmi i Përbashkët i Mbikëqyrjes (SSM), për mbikëqyrjen e përditshme të bankave; 2) Mekanizmi i Përbashkët për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme (SRM), për të shpëtuar bankat nga kriza; dhe 3) propozimi për skemën evropiane të sigurimit të depozitave (EDIS). SSM

dhe SRM janë themeluar në vitin 2014 dhe 2015 dhe janë tashmë plotësisht funksionale, ndërsa EDIS është ende në diskutim. UB-ja filloi me Shtetet Anëtare të Eurozonës. Së fundmi Bullgaria ka aplikuar, gjithashtu, për t'u bashkuar me UB-në<sup>2</sup>.

SSM u themelua në maj 2014 dhe përfshin Bankën Qendrore Evropiane (BQE) dhe autoritetet mbikëqyrëse kombëtare të vendeve pjesëmarrëse. Aktualisht, SSM mbikëqyr 118 banka sistemike<sup>3</sup> në UB. SRM plotëson SSM-në; misioni i tij është të sigurojë një mekanizëm të kontrolluar ndërhyrjeje të jashtëzakonshme në bankat që falimentojnë, me një ndikim minimal në ekonominë reale, sistemin financiar dhe taksapaguesit e shteteve anëtare pjesëmarrëse, e më gjerë. Ai mbulon të gjitha bankat e mbikëqyrura nga SSM, si dhe filialet e 13 grupeve ndërkufitare në Shtetet e tjera Anëtare<sup>4</sup>. Vendimmarrja solide, e centralizuar dhe e pavarur për të gjitha bankat në eurozonë, nga ana e SSM-së dhe/ose SRM-së, siguron që vendimet në Shtetet Anëtare të merren në mënyrë efektive dhe të shpejtë, duke shmangur veprimet e pakoordinuara.

SRM u krijua në janar 2015, i përbërë nga Bordi i Përbashkët i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (SRB) dhe autoritetet kombëtare të ndërhyrjes së jashtëzakonshme (NRA-të) të vendeve pjesëmarrëse. SRM u bë plotësisht funksional, me autoritet fuqiplotë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, më 1 janar 2016. Për të përmbushur misionin e saj, SRB bashkëpunon

<sup>1</sup> Adamczyk G. and Windisch B. (2015): 'State aid to European banks: returning to viability', European Commission, [http://ec.europa.eu/competition/publications/csb/csb2015\\_001\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/competition/publications/csb/csb2015_001_en.pdf)

<sup>2</sup> <https://www.reuters.com/article/bulgaria-eurozone/bulgaria-to-formally-apply-to-join-eus-banking-union-idUSL8N1U8150>

<sup>3</sup> Bazuar në listën e SSM-së të datës 2 janar 2019: [https://www.bankingsupervision.europa.eu/ecb/pub/pdf/ssm.list\\_of\\_supervised\\_entities\\_201901-cc10da7690\\_en.pdf](https://www.bankingsupervision.europa.eu/ecb/pub/pdf/ssm.list_of_supervised_entities_201901-cc10da7690_en.pdf)

<sup>4</sup> Shihni listën e SRB-së të shkurtit 2018: [https://srb.europa.eu/sites/srbsite/files/5\\_for\\_publication\\_srb\\_website\\_list\\_of\\_other\\_cross\\_border\\_groups\\_1februar.pdf](https://srb.europa.eu/sites/srbsite/files/5_for_publication_srb_website_list_of_other_cross_border_groups_1februar.pdf)

ngushtë me SSM dhe NRA-të në UB, si dhe në BE përmes kolegjeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. SRB është përgjegjëse për menaxhimin e Fondit të Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, që mund të përdoret, në raste të jashtëzakonshme, për të mbuluar humbjet (pasikreditorët e bankës në paaftësi paguese të kenë përthithur humbjet në masën 8% të totalit të detyrimeve dhe fondeve të veta). SRB mbledh kontribute nga të gjitha bankat në UB, për të plotësuar fondin derisa ai të arrijë në madhësinë e 1% të depozitave të mbuluara të të gjitha bankave në UB.

Baza ligjore për SRM-në mbështetet kryesisht në Rregulloren e Mekanizmit të Përbashkët për Ndërhyrje të Jashtëzakonshme (SRMR)<sup>5</sup> dhe Direktivën e Rimëkëmbjes dhe Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në Banka (BRRD)<sup>6</sup>, që krijon një regjim evropian për ndërhyrje të jashtëzakonshme në institucionet financiare, përfshirë bankat. Regjimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme u japin autoriteteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme kompetencat dhe mjetet e nevojshme, për të siguruar një ndërhyrje të jashtëzakonshme të kontrolluar në banka, pra ndërhyrjen në një banke që është në ose pranë një situate të paaftësisë paguese (FOLTF), duke minimizuar pasojat mbi stabilitetin financiar, ekonominë reale dhe paratë e taksapaguesve. Përveç mjeteve që janë përdorur më parë për shpëtimin e bankave që falimentojnë, si "ndarja e aktiveve" (kryesisht për huat me probleme), shitja e biznesit dhe "banka-urë", BRRD-ja ka shtuar edhe një mjet të ri ndërhyrjeje, të quajtur "rikapitalizim nga brenda". Njëpërmjet këtij instrumenti, humbjet mbarten nga aksionarët dhe kreditorët e bankës në paaftësi paguese, dhe - nëse është e nevojshme - autoritetet

e ndërhyrjes së jashtëzakonshme vendosin që ata ta rikapitalizojnë bankën, për të siguruar vazhdimësinë e funksioneve me rëndësi kritike dhe për të zbutur ndikimin e falimentimit të saj në stabilitetin financiar.

## **2. Zhvillimet e fundit në kuadrin rregullator për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Evropë.**

Kuadri ligjor për ndërhyrjen e jashtëzakonshme (SRMR, BRRD) dhe kërkesat prudenciale (CRD/CRR) është ende në diskutim, në pritje për t'u finalizuar në vitin 2019. Ndryshimet kryesore përfshijnë integrimin e kërkesave për Kapacitetin Total të Përthithjes së Humbjeve (TLAC) për Bankat me Rëndësi Sistemike Globale (G-SIB) në kërkesat minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar (MREL) të BE-së për grupet më të mëdha bankare; ndryshimet në karakteristikat kryesore të MREL-it, duke përfshirë një kuadër të caktuar për kërkesat minimale dhe detyrimet e pranuar (MREL) brenda grupit; një instrument të ri moratoriumi për autoritetet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme; dhe një kërkesë për disa grupe bankare të vendeve të treta, që veprojnë në BE, për të krijuar shoqëri më të ndërmjetme. Përtej kuadrit rregullator, edhe konteksti më i gjerë institucional dhe politik është, gjithashtu, në lëvizje. Përpjekjet në vijim, si pjesë e "planit të reformimit të eurozonës" po përqendrohen, ndër të tjera, në: udhërrëfyesin për fillimin e diskutimeve politike mbi EDIS, kuadrin e mundshëm për likuiditetin në rastin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, kalendarin për reformën e Mekanizmit Evropian të Stabilitetit, përfshirë këtu edhe mekanizmin mbështetës të SRF-së.

Një ngjarje e rëndësishme në vitin

2019 është "Brexit", që mund të rrisë numrin e bankave të rëndësishme nën përgjegjësinë e SRB-së. Në nëntor 2018, SRB publikoi një raport mbështetës mbi Brexit, duke përfshirë pritshmëritë e SRB-së në raport me të gjitha bankat aktive në UB, për të përmbushur një listë të caktuar të kushteve për mundësinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Udhëzimi fokusohet në gjashtë fusha kryesore: përshtatshmëria e MREL-it, përthithja e brendshme e humbjeve, vazhdimësia operacionale, qasja në infrastrukturën e tregut financiar (FMI), sistemet e qeverisjes dhe menaxhimit të informacionit.

## **3. Përgjigjja e bankave dhe institucioneve të tjera ndaj masave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.**

Bankat kanë qenë të përgjegjshme dhe bashkëpunuese ndaj gjithë veprimtarisë së kryer për SRB-në, e kjo bazuar në informacionin që ato ofrojnë nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme të grumbullimit të të dhënave, takim-diskutimeve të rregullta me autoritetet dhe vendimet e nxjerra nga SRB-ja, përfshirë këtu dhe vendosjen e objektivave për MREL-in. Plani i ndërhyrjes së jashtëzakonshme hartohet në bazë të të dhënave dhe informacioneve nga bankat dhe strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme i komunikohet menaxhimit të bankës. Për më tepër, vlerësimi i mundësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në bankë kërkon një komunikim nga afër dhe të qartë me bankat, si dhe një plan të zhvilluar së bashku, mbi atë se si duhen kapërcyer pengesat për realizimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

## **4. Progresi i SRB në ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka dhe mjetet e përdorura.**

Për të siguruar një ndërhyrje të jashtëzakonshme të kontrolluar, SRB-

<sup>5</sup> Rregullorja (EU) No 806/2014 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 15 korrik 2014, që përcaktojnë rregulla dhe procedura uniforme për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet e kreditit dhe në disa firma investimesh, në kuadër të Mekanizmit të Përbashkët për Ndërhyrje të Jashtëzakonshme dhe Fondit të Përbashkët për Ndërhyrje të Jashtëzakonshme, si dhe Rregullorja (EU) No 1093/2010, e ndryshuar.

<sup>6</sup> Direktiva 2014/59/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 15 maj 2014, që përcakton kuadrin për ndërhyrje të jashtëzakonshme në institucionet e kreditit dhe firmat e investimeve dhe në Direktivën e Këshillit 82/891/EEC, të ndryshuar, dhe Direktivat 2001/24/EC, 2002/47/EC, 2004/25/EC, 2005/56/EC, 2007/36/EC, 2011/35/EU, 2012/30/EU dhe 2013/36/EU, dhe Rregulloret (EU) No 1093/2010 dhe (EU) No 648/2012, të Parlamentit dhe Këshillit Evropian.

ja përqendrohet në tri detyra kryesore të ndërhyrjes së jashtëzakonshme: zhvillimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, përcaktimin e MREL-it dhe vlerësimin e mundësisë për ndërhyrje në secilën bankë. Përveç kësaj, SRB-ja ka zhvilluar procese dhe procedura për menaxhimin e krizave, duke marrë parasysh edhe përvojat e kaluara.

#### *Detyrat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme*

Detyra e parë themelore është hartimi i planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të cilat janë kritike për të kuptuar plotësisht gjendjen e bankave, për të vlerësuar funksionet kritike për ekonominë, për të përgatitur vlerësimin e interesit publik dhe, nëse ndërhyrja e jashtëzakonshme gjykohet e përshtatshme, të hartojë strategjinë e preferuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme. SRB-ja ka hartuar planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjitha bankat nën autoritetin e saj dhe do të përqendrohet në fushat e synuara, si pjesë e zhvillimit të mëtejshëm të këtyre planeve.

Detyra e dytë kryesore e SRB-së është vendosja e niveleve të përshtatshme të MREL-it, me qëllim që, nëse ndodh një krizë, të ekzistojnë detyrime të mjaftueshme për të përthithur humbjet dhe, nëse është e nevojshme, për të rikapitalizuar institucionin. Vendosja e MREL-it kërkon sigurimin e të dhënave të hollësishme rreth detyrimeve të bankës, të paktën mbi baza vjetore. Procesi i grumbullimit të të dhënave, duke përfshirë zhvillimin e ndërfaqjeve informatike me bankat, ka ecur shumë mirë dhe është automatizuar me kalimin e kohës. SRB-ja është tashmë në vitin e tretë të vendosjes së objektivave për MREL-in në nivel të konsoliduar për grupin. Në vitin 2019, SRB do të fillojë vendosjen e objektivave për MREL-in edhe në nivel individual për filialet e rëndësishme.

Detyra e tretë kryesore është

vlerësimi i mundësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në bankë, që është dhe fokusi kryesor gjatë vitit 2019. Rritja e afësisë së bankës për ndërhyrjet jashtëzakonshme përfshin operacionalizimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Për instrumentin e "rikapitalizimit nga brenda" (bail-in), (disa) banka do të duhet të zhvillojnë një udhëzues se si të procedojnë për zhvlerësimin (write-down) ose për kapitalizimin nga brenda (bail-in). SRB dhe NRA-të janë gjithashtu në kontakt me FMI-të, për të lehtësuar ekzekutimin në praktikë të rikapitalizimit nga brenda.

#### *Zhvillimet e politikave*

Qëndrueshmëria e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe veprimeve të lidhura me të mbështetet nga zhvillimi i vazhdueshëm i politikave të SRB-së, të cilat shërbejnë si udhëzues për ekipet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në vitin 2019 do të ketë disa politika të rëndësishme të SRB-së, të tilla si përcaktimi i MREL-it, operacionalizimi i instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, vijueshmëria operacionale e bankave, vlerësimi dhe raportimi në kuadër të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

#### *Menaxhimi i krizave*

SRB vendosi për ndërhyrje të jashtëzakonshme në rastin e Banco Popular në 2017-ën. Për shkak të situatës problematike të likuiditetit, BQE vendosi më 6 qershor 2017 se Banco Popular klasifikohet pranë paftësisë paguese (FOLTF) dhe njoftoi SRB-në me këtë rast. SRB-ja dhe NRA-ja spanjolle vendosën se ndërhyrja e jashtëzakonshme ishte në interes publik, për të mbrojtur depozituesit e Banco Popular dhe për të siguruar stabilitetin financiar. Skema e ndërhyrjes së jashtëzakonshme hyri në fuqi në po të njëjtën ditë, pas miratimit nga Komisioni Evropian. Më 7 qershor 2017, SRB mori vendimin për ta shitur bankën te Banco Santander. Banco Popular vijoi të operonte në kushte normale pune si

një bankë e shëndetshme dhe likuide, anëtare e Grupit Santander, me efekt të menjëhershëm. Ky ishte një shembull i mirë i një ndërhyrjeje të jashtëzakonshme të kontrolluar në një bankë.

Në rastet e tjera të bankave të klasifikuara pranë paftësisë paguese (FOLTF) deri më tani, për dy banka veneciane në vitin 2017 dhe një bankë letoneze në 2018-ën, SRB-ja mori vendimin se ndërhyrja e jashtëzakonshme nuk ishte në interesin publik.

#### **5. Bashkëpunimi i SRB-së me autoritetet përkatëse në vendet jo-anëtare të BE-së.**

SRB bashkëpunon me autoritetet në vendet jo anëtare të BE-së në forma të ndryshme. Për subjektet e klasifikuara si G-SIB, janë ngritur grupe të Menaxhimit të Krizave (CMG-të), siç rekomandohet nga Bordi i Stabilitetit Financiar. CMG-të përbëhen nga autoritetet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, autoritetet mbikëqyrëse, bankat qendrore, ministritë e financave dhe autoritetet publike, përgjegjëse për sigurimin e depozitave (DGS-të) të vendeve ku ushtrojnë veprimtari subjektet G-SIB, që konsiderohen si të rëndësishëm për ndërhyrje të jashtëzakonshme të mundshme në subjektet e klasifikuara si G-SIB. SRB-ja ka lidhur marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi me vendet e treta, si: FDIC në SHBA, Korporata e Sigurimit të Depozitave në Kanada, Bankën e Brazilit, Bankën e Shqipërisë, Bankën Kombëtare të Serbisë dhe Institutin Meksikan për Mbrojtjen e Kursimeve Bankare. Përzgjedhja e autoriteteve të vendeve të treta për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh lidhet ngushtë me nevojat e planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, nëse institucionet e UB-së kanë një prani të caktuar atje; ose nisma vjen nga vet autoritetet e vendeve të treta.

## Shërbimet e integruara të Llogarisë Direkte



**ProCredit Bank**

**DIRECT**

**Të gjitha në një!**

**Thjesht dhe sigurt**

[procreditbank-direct.com](http://procreditbank-direct.com)

# SNRF 9

## Një vit më pas

*Pas fazës së parë, mbetet shumë për të bërë, lidhur me optimizimin e proceseve, konsolidimin e njohurive të përdorura deri tani, përditësimin e modeleve, e për më tepër, harmonizimin e përpjekjeve të bankave dhe Bankës Qendrore, me qëllim standardizimin e përqasjes ndaj zbatimit të këtij standardi.*



**Julian ÇELA**

Drejtor i Divizionit të Kontrollit Financiar  
Intesa Sanpaolo Bank Albania

**K**a kaluar më shumë se një vit nga data e zbatimit të detyrueshëm të standardit ndërkombëtar të raportimit financiar (SNRF) 9. I cilësuar si standardi me ndryshimet më të rëndësishme në 10 vjeçarin e fundit, zbatimi i tij kërkoi angazhimin e një numri të madh burimesh njerëzore, përfshirjen e sistemeve të TIK-ut dhe të raportimit financiar. Shumë banka evropiane nisën projektet për zbatimin e këtij standardi në mesin e vitit 2015, një periudhë kjo relativisht e gjatë për zbatimin e një standardi ndërkombëtar të raportimit financiar.

Pa u përqendruar në detaje, për atë që lamë pas, në vijim renditen disa nga sfidat të cilat u kaluan gjatë fund vitit 2017 si dhe në vitin 2018: 1) adoptimi i metodologjive të llogaritjes së zhvlerësimit; 2) zbatimi praktik, apo përshtatja /krijimi i sistemeve TIK për llogaritjen e zhvlerësimit; 3)

ndryshimet në raportimin financiar (FINREP), si dhe ndryshimet në shënimet e pasqyrave financiare; 4) krijimi i të dhënave historike për modelet e rrezikut; rishikimi i procedurave të huadhënies, etj.

Edhe sot, më shumë se një vit nga data e zbatimit, mbetet ende shumë për të bërë në optimizimin e procesit të përllogaritjes së zhvlerësimit. Sistemet e reja të informacionit që u vunë në zbatim për të mundësuar aplikimin e SNRF 9 janë shumë komplekse dhe ecuria operationale e tyre ka nevojë për përmirësime të vazhdueshme. Përpjekjet bëhen me qëllim përmirësimin e cilësisë së informacionit të nevojshëm, për përditësimin e parametrave të rrezikut.

Përfshirja në përllogaritje të informacioneve komplekse, si p.sh.: parashikimi i skenarëve makroekonomikë, kërkon nga bankat që të ndërtojnë modele për të cilat mungon ekspertiza. Në këtë drejtim, kontributi i Bankës Qendrore mund të ishte vërtet i rëndësishëm. Për më tepër, duke qenë se SNRF 9 është më prudenste se SNK 39 në llogaritjen e provizioneve për huat në gjykimin tim, do të ishte koha e përshtatshme për rregullatorin që të hiqte raportimin e dyfishtë për bankat, për sa i përket zhvlerësimit të huave. Po ashtu, SNRF 9 e ka zgjeruar listën e mjeteve të cilat janë subjekt i zhvlerësimit, siç janë vendosjet në banka, titujt, si dhe llogaritë me bankat rezidente. Sfidat vijojnë të jenë të pranishme dhe lidhen me vështirësitë për të parashikuar luhatjet jo të vogla të fondit të zhvlerësimit. Duhet thënë

se zbatimi i SNRF 9 ka sjellë shumë vështirësi për bankën, për sa i përket ciklit të planifikimit. Zbatimi i standardit të ri vazhdon të jetë sfidues për përgatitjen e shënimeve sqaruese të pasqyrave financiare, që kërkon përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të raportimit dhe përpunimit të informacionit. Një sfidë e rëndësishme, që po hasin të gjitha bankat, lidhet me ndikimin dhe zbatimin fiskal të SNRF 9. Sot, më shumë se një vit nga zbatimi i SNRF 9, nuk është bërë asgjë për përshtatjen e legjislacionit tatimor me kërkesat e reja të standardit, e për më tepër, autoritetet tatimore nuk kanë një qëndrim përfundimtar, lidhur me njohjen për efekte fiskale të rezervës të krijuar në datë 1 janar 2018, në kapital. Duhet përmendur se, shumë vende evropiane kanë bërë saktësime në legjislacionin fiskal, duke dhënë udhëzime të qarta se si do të bëhet njohja e fondit shtesë të zhvlerësimit, për arsye fiskale.

Si përfundim, mund të themi që, pas fazës së parë, që kërkoi angazhimin e bankave, kryesisht për sa i përket teknologjisë së informacionit dhe menaxhimit të rrezikut, mbetet shumë për të bërë lidhur me optimizimin e proceseve, konsolidimin e njohurive të përdorura deri tani, përditësimin e modeleve, e për më tepër, harmonizimin e përpjekjeve të bankave dhe Bankës Qendrore, me qëllim standardizimin e përqasjes ndaj zbatimit të këtij standardi.

# Raporti i vlerësimit të MONEYVAL

## Plane dhe veprime për një luftë më efikase ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

*Qasja dhe filozofia e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) bazohet mbi bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe krijimin një partneriteti të ngushtë midis sektorit publik dhe atij privat, si mënyra më e frytshme për të parandaluar e luftuar me sukses fenomenin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për të krijuar një mjedis sa më të shëndetshëm për ekonominë dhe sigurinë në vendin tonë.*



### Arlind GJOKUTA\*

Drejtor i Përgjithshëm  
Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të  
Pastrimit të Parave

Vendi ynë ka kaluar së fundmi një proces vlerësimi nga Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i njohur ndryshe si Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës. Metodologjia e vlerësimit u bazua mbi 40 Rekomandimet e Financial Action Task Force (FATF), ose organizmi ndërkombëtar që vendos standardet në fushën e parandalimit dhe luftës ndaj pastrimit të parave (PP) dhe financimit të terrorizmit (FT). Për herë të parë metodologjia përfshin, përveç vlerësimit të

përputhshmërisë teknike (sa përputhet kuadri ligjor i një shteti me 40 Rekomandimet), edhe vlerësimin e efektivitetit në zbatimin e bazës ligjore.

Raporti paraqet një panoramë gjithëpërfshirëse dhe objektive të masave të marra nga vendi ynë dhe rezultateve të arritura gjatë periudhës 2011-2017. Vlerësimi konkludon që, për sa i përket pjesës teknike, vendi merr një rezultat relativisht të mirë, pasi nga 40 rekomandimet, vetëm 10 janë të përmbushura pjesërisht dhe 1 rezulton i pa përmbushur. Ndërkohë, në lidhje me efektivitetin, rezultati është në linjë me mesataren e vendeve të vlerësuara nga Moneyval dhe rezulton se nga 11 rezultatet kryesore, 2 janë me efektivitet të ulët, 7 me efektivitet të moderuar dhe 2 të tjera me efektivitet thelbësor.

Në shtator 2018, Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP), si organi më i lartë në vend përgjegjës për përcaktimin e drejtimeve të politikës shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër PP/FT, ka miratuar një plan të detajuar veprimi për trajtimin e rekomandimeve. Plani i veprimit synon përshtatjen e bazës ligjore në mënyrë që rekomandimet

që rezultojnë të përmbushura pjesërisht, të vlerësohen të paktën gjerësisht të përmbushura. Lidhur me rekomandimin e pa përmbushur, që lidhet me bazën ligjore për sanksionet ndaj financuesve të armëve të shkatërrimit në masë, ai parashikon miratimin e një ligji të ri. Plani adreson edhe masa konkrete, lidhur me përmirësimin e efektivitetit, duke nxitur më tej bashkëpunimin e strukturave të përfshira.

Për sa i përket ndryshimeve ligjore, nevojat e evidentuara synojnë prekje jo thelbësore të një numri të moderuar ligjesh ekzistuese, ndërkohë që janë hartuar dhe janë gati për miratim edhe 2 ligje të reja. Gjithashtu, në periudhën afatmesme, do të përshtatet e përgatitet baza ligjore për ngritjen e dy regjistrave shumë të rëndësishëm, që do të ndikojnë në rritjen e efektivitetit dhe transparencës: regjistri qendror i llogarive bankare dhe regjistri i pronarëve përfitues. Ngritja e këtyre regjistrave kërkohet nga Direktiva IV dhe V e BE-së për masat kundër PP/FT e për rrjedhojë nuk është detyrim me efekt të menjëhershëm për vendin tonë, por angazhimi i marrë tregon vullnetin e autoriteteve për të rritur transparencën në

\* Z. Gjokutaj ka mbajtur këtë pozicion deri në fund të muajit mars 2019.



lidhje me strukturat komplekse të pronësisë, si dhe përafrimin me legjislacionin dhe standardet e BE-së në këtë drejtim. Konkretisht, ndryshimet ligjore në proces synojnë të përmirësojnë mekanizmat që sigurojnë saktësinë dhe përditësimin e informacionit mbi pronësinë e personave juridikë, kanalizimin e transaksioneve drejt sistemit bankar, kufizimin e përdorimit të parasë fizike, forcimin e mbikëqyrjes dhe rritjen e transparencës e llogaridhënies në funksionimin e OJF-ve, etj.

Në mënyrë të posaçme do doja të ndalesha e të prezantoja ndryshimet që prekin ligjin nr.9917, datë 19.05.2008: "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar. Në tërësinë e tij ligji është vlerësuar pozitivisht dhe si në përputhje me standardet kryesore të FATF-së, mirëpo nevojiten sërish ndërhyrje për përafrim me ato kritere, për të cilat është marrë një vlerësim jo i përshtatshëm. Një pjesë e ndryshimeve që prekin këtë ligj kanë të bëjnë me saktësimin e disa përkufizimeve, në mënyrë që të shmangen keqinterpretimet e mundshme, siç është rasti i përkufizimit të produktit të veprimtarisë kriminale, transaksionit etj. Gjithashtu, ndryshimet synojnë ofrimin e alternativave të reja, të cilat kanë për qëllim të lehtësojnë punën e subjekteve të këtij ligji dhe klimën e biznesit me klientët e tyre, siç është mbështetja në palë të treta, proces i cili synon uljen e kostove administrative për marrëdhënien me një kategori të caktuar klientësh, si dhe rritjen e shpejtësisë së ndërveprimit në vendosje marrëdhënie biznesi dhe kryerje transaksionesh. Element tjetër risie që vlen të evidentohet është edhe koncepti i vigjilencës

së thjeshtuar, që do të aplikohet për një kategori të përcaktuar në projektligj, por që është dinamik dhe do të ndikohet edhe nga konkluzionet e vlerësimit të rrezikut për PP/FT si dhe vlerësime të tjera sektoriale.

Në linjë me zhvillimet teknologjike dhe duke synuar rregullimin e veprimtarive të reja, në bazë të rekomandimeve të FATF-së që janë dinamike në këtë drejtim, në ligj përfshihet përkufizimi i aktiveve virtuale dhe ofruesit e shërbimeve të tyre konsiderohen si subjekte raportuese të ligjit. Ky është veçse një hap i parë për vendosjen e standardit në këtë fushë, ndërsa veprimtaria e kësaj kategorie në tërësi do të kërkojë rregullim të posaçëm më pas, në përputhje edhe me rekomandimet dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare.

Duke konsideruar vëmendjen, ndjeshmërinë dhe kërkesat në rrafshin ndërkombëtar mbi çështjet e financimit të terrorizmit, zbatimin pa vonesë të sanksioneve të vendosura nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së për terrorizëm dhe financim terrorizmi, si dhe marrjen e masave të përshtatshme për vendet me rrezik, ndryshimet ligjore në proces kanë trajtuar edhe këto çështje, duke synuar një mbrojtje të vendit në një rrafsh më të gjerë ekonomik dhe gjeopolitik. Vend të veçantë në këto ndryshime kanë kërkesat tanimë të drejtpërdrejta për vlerësime individuale rreziku për PP/FT të subjekteve, dokumentim të këtyre vlerësimeve dhe përshtatjen e vazhdueshme të tyre, duke diktuar në këtë mënyrë edhe masat që duhet të merren në raport me klientët, apo transaksione të kategorive të caktuara. Ndryshimet e propozuara synojnë edhe saktësimin e periudhës dhe kohëzgjatjes që një individ konsiderohet Person i Ekspozuar

politikisht (PEP), në përputhje me rrezikun e vendit, eksperiencën e fituar nga DPPPP ndër vite, në lidhje me transaksionet që kjo kategori ka kryer, si dhe praktikrat ndërkombëtare. Gjithashtu, janë bërë disa saktësime të detyrave dhe kompetencave të DPPPP-së, si dhe parashikohet një gamë më e gjerë dhe e larmishme e masave administrative, që mund të merren në rast shkelje nga ana e subjekteve.

Një ndër risitë e këtij ligji është trajtimi i problematikës së mos deklarimit të vlerave monetare në kufij, nëpërmjet vendosjes edhe të masave administrative përshkallëzuese, në rastet e mos respektimit të këtij detyrimi. Kjo pritet të ketë ndikim duke ulur rastet e mos deklarimit, pasi është një element shtesë frenues, krahas dispozitave që gjenden në Kodin Penal, por gjithashtu ofron një mekanizëm nxitje për autoritetet doganore, të cilat pritet që një pjesë të shumave të arkëtuara ti përdorin për përmirësimin e infrastrukturës së kontrollit në të gjitha pikat kufitare. Gjithashtu, bëhet edhe një unifikim i shumës së detyrueshme për deklarim me vendet e BE-së dhe vendet e rajonit, për të evituar pragjet e dyfishta që ekzistojnë në vendet me të cilat kemi më shumë lëvizje pasagjerësh.

Në hartimin e këtyre ndryshimeve ka pasur një komunikim e konsultim konstant e të hapur me grupet e interesit, veçanërisht me sektorin bankar e financiar në vend. Qasja dhe filozofia e DPPPP-së bazohet mbi bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe krijimin një partneriteti të ngushtë midis sektorit publik dhe atij privat, si mënyra më e frytshme për të parandaluar e luftuar me sukses fenomenin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për të krijuar një mjedis sa më të shëndetshëm për ekonominë dhe sigurinë në vendin tonë.

Fonde Investimi

# INVESTO

**E ARDHMJA TINGËLLON MË BUKUR  
SË BASHKU**

Zgjidh planin e investimit në fondet e Raiffeisen Invest

[www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al)



**Raiffeisen  
INVEST**

# Letrat me vlerë private

## Ku është sipërmarrja shqiptare?

*Sipërmarrja shqiptare duhet të jetë e aftë t'i përgjigjet mjedisit të ri që po krijohet në fushën e burimeve të financimit, atë të emetimit të obligacioneve të korporatave private, duke përshtatur modelet e administrimit drejt një qeverisje korporative të shëndoshë dhe rritjes së transparencës së raportimit të pasqyrave financiare.*



**Blodin ÇUÇI**

Administrator

CAESAR INVESTMENT ADVISORY SERVICES

**S**i në ekonomitë e zhvilluara, ashtu edhe në ekonomitë në zhvillim, tregu i emetimit të obligacioneve dhe aksioneve nga sipërmarrjet private është një ndër treguesit kryesorë të nivelit të zhvillimit financiar të një vendi. Për sa i përket tregut ndërkombëtar të obligacioneve, vëllimi i emetimit botëror të tyre ka arritur vlerën totale prej 240 trilionë dollarë, ndërsa në Europë tregu i obligacioneve të sipërmarrjeve private jo-financiare, në fund të vitit 2017, arriti në 66 trilionë euro. Në Shqipëri, në fund të muajit dhjetor 2018, madhësia e tregut të emetimit të obligacioneve të korporatave private në Shqipëri arriti 4,65 miliardë lekë (37,8 milionë euro).

Ndonëse tregu i kapitaleve në

mjedisin ekonomik shqiptar gjendet në fazat embrionale, gjatë viteve të fundit disa nga sipërmarrjet private më cilësore shqiptare kanë emetuar në mënyrë të suksesshme obligacione. Në mars 2017, NOA emetoi një obligacion 3-vjeçar në lek; shuma e emetuar ishte 80 milionë lek. Po këtë vit, Balfin Group emetoi një letër tregtare me një shumë prej 60 milionë lek, me afat maturimi 8 mujor. Nga viti 2017, Credins Bank emeton në mënyrë të rregullt obligacione të konvertueshme. Ky është një instrument me të ardhura fikse, që mund të konvertohet në aksione. Të dhënat deri në tremujorin e tretë të 2018-ës tregojnë se emetimet e obligacioneve të Bankës Credins kanë arritur shumën prej 4,26 miliardë lek në monedha të ndryshme: Euro, USD dhe Lek. Në vitin 2018, Digitalb ishte institucioni i parë jo-financiar që emetoi një obligacion të garantuar 3-vjeçar në euro. Në muajt e ardhshëm dhe përgjatë vitit 2019 pritet që institucione të tjera bankare, si dhe korporata të njohura shqiptare t'i shtohen listës së emetuesve, duke zgjeruar këtë treg dhe rritur numrin e instrumenteve në dispozicion të investuesve. Në fillim të vitit 2019, Banka Credins emetoi përsëri në monedhat euro, lek dhe USD, ndërkohë në gjysmën e parë të vitit pritet edhe emetimi i obligacionieve me ofertë private nga emetues të rinj.

Infrastruktura e tregut financiar u plotësua nga fillimi i operacioneve të ALSE – Bursa Shqiptare e

Titujve dhe së shpejti pritet edhe fillimi i operacioneve të ALREG – Regjistri Shqiptar i Titujve. Të dy këto institucione krijojnë bazat për zhvillimin e një tregu të shëndoshë të letrave me vlerë të sipërmarrjes shqiptare, si obligacione dhe aksione, ku pritet që këtë vjeshtë të listohen dhe kuptohen edhe titujt e parë të korporatave private shqiptare. Krijimi i ALSE dhe ALREG pritet të gjallërojë dhe zmadhojë tregun e emetimeve të obligacioneve dhe aksioneve të sipërmarrjeve, duke ofruar infrastrukturën për emetim me ofertë publike.

Të shumtë janë faktorët që po ndikojnë në rritjen e interesit në tregun e emetimit të obligacioneve të korporatave. Shtrëngimi i kushteve të huadhënies nga sistemi bankar vendas dhe mjedisi me norma të ulëta interesi janë, ndër të tjera, shtytës të rëndësishëm të një interesi në rritje nga ana e korporatave për të emetuar dhe investuesve privat për të investuar. Gjithashtu, nevoja e sipërmarrjes shqiptare për të diversifikuar burimet e financimit dhe ulur varësinë nga forma tradicionale të financimit, së bashku me zhvillimet në tregun shqiptar të kapitaleve ka shtuar interesin në mjedisin sipërmarrës shqiptar drejt këtyre formave të financimit. Nga ana tjetër, kanalet tradicionale të financimit të sipërmarrjes nuk po arrijnë të përmbushin nevojat e sipërmarrjes për financim. Sipas Bankës së Shqipërisë, ecuria e huas

po pasqyron zhvillimet e plogështa të huas për biznes.

Nga sa më lart, natyrshëm lind pyetja: A është e përgatitur sipërmarrja shqiptare të përfitojë nga përparësitë e këtij tregu? Së pari, përgjigjja ka të bëjë drejtpërdrejt me problematikat e sipërmarrjes shqiptare, ku ndër të tjera, veçohet cilësia e qeverisjes së korporatave, që është sistemi i rregullave, praktikave dhe proceseve, përmes të cilave drejtohet dhe kontrollon një sipërmarrje. Duke qenë se qeverisja korporative siguron gjithashtu edhe bazën për arritjen e objektivave të një shoqërie, ajo përfshin praktikisht çdo sferë të administrimit, nga planet e veprimit dhe auditet e brendshme, deri te matja e ecurisë dhe transparencës së pasqyrave financiare të korporatave.

Ndonëse një pjesë e mirë e sipërmarrjeve shqiptare kanë investuar në ngritjen e modeleve dhe praktikave më të mira të tregut, për sa i përket qeverisjes së korporatave, transparencës dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare, pjesa më e madhe e sipërmarrjes shqiptare është ende larg krijimit të standardeve të pranueshme, për të krijuar besimin e investuesve. Krijimi i besimit të investuesve është dhe sfida kryesore e sipërmarrjes shqiptare, drejt thithjes së fondeve të investuesve privatë. Për këtë arsye, krijimi i sistemeve të qeverisjes së korporatave, së bashku me transparencën në raportimin e pasqyrave financiare, janë kolonat mbajtëse të krijimit të këtij besimi. Ndonëse kushtet e tregut janë pjekur për korporatat e shqiptare për të emetuar dhe thithur fonde nëpërmjet

këtij tregu, mbetet ende shumë për të bërë nga pjesa dërrmuese e sipërmarrjes shqiptare, në kuadër të ndërtimit dhe konsolidimit të qeverisjes së korporatave.

Në këndvështrimin e investuesve, dinamikat e ecurisë në rënie të normave të interesit i kanë bërë këta të fundit të kërkojnë produkte me norma më të larta interesi. Këtë e konfirmon, ndër të tjera, edhe sjellja e tyre, ku zhvendosja kryesore e investimeve vihet re drejt depozitave me afate mbi dy vjet, veçanërisht në monedhën vendase. Prirja e investuesve privat drejt përzgjedhjes



Shtrengimi i kushteve të huadhënies nga sistemi bankar vendas dhe mjedisi me norma të ulëta interesi janë, ndër të tjera, shtytës të rëndësishëm të një interesi në rritje nga ana e korporatave, për të emetuar dhe investuesve privat për të investuar. Gjithashtu, nevoja e sipërmarrjes shqiptare për të diversifikuar burimet e financimit dhe ulur varësinë nga forma tradicionale të financimit, së bashku me zhvillimet në tregun shqiptar të kapitaleve ka shtuar interesin në mjedisin sipërmarrës shqiptar drejt këtyre formave të financimit.



së produkteve me norma interesi më të lartë është një tregues i interesit potencial për të kanalizuar këtë masë likuiditeti drejt obligacioneve të sipërmarrjes shqiptare. Gjithsesi,

duhet pasur parasysh një tjetër sfidë, që vjen si pasojë e fazës embrionale në të cilën gjendet tregu shqiptar; ajo e mosnjohjes së këtyre produkteve dhe e nivelit të ulët të njohurive financiare të publikut mbi këto instrumente.

Në përfundim, një treg kapitalësh i zhvilluar është domosdoshmëri për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik, pasi zvogëlon trysinë mbi sektorin bankar, duke shpërdarë në mënyrë më efikase rrezikun në sistem, ju siguron sipërmarrjeve private një burim të qëndrueshëm financimi, ul kostot e financimit për to, rrit transparencën në qeverisjen e korporatave dhe zgjeron bazën e produkteve dhe alternativave të investimit në treg. Në Shqipëri, ndonëse në fillimet e tij, emetimet e sukseshme të disa korporatave kanë treguar se ekzistojnë bazat e shëndosha për zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu. Krijimi i infrastrukturës së Bursës dhe Regjistrimit të Titujve do ta zhvillojë edhe më tej këtë treg, duke zgjeruar bazën e investuesve. Në këtë aspekt, sipërmarrja shqiptare duhet të jetë e aftë t'i përgjigjet mjedisit të ri që po krijohet në fushën e burimeve të financimit, atë të emetimit të obligacioneve të korporatave private, duke përshtatur modelet e administrimit drejt një qeverisje korporative të shëndoshë dhe rritjes së transparencës së raportimit të pasqyrave financiare. Kjo do të konsolidojë besimin e investuesve, çka do të sjellë për korporatat burime alternative financimi me norma interesi më të ulëta, në periudhën afatgjatë.



# Ndikimi i kërkesave të raportimit në huadhënien e bankave

*Faktikisht, pasqyrat zyrtare janë të domosdoshme, por që procesi të jetë i shëndetshëm dhe të japë ndikim për një zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm duhet që, krahas tyre bankat të bëjnë analiza të thelluara, të përdorin informacione financiare parashikuese, si dhe një mori të dhënash të tjera jo-financiare, të cilat duhet të jenë të kuptueshme, të besueshme dhe të përshtatshme.*



**Prof. Dr. Hysen ÇELA, CA, CPA**  
President  
INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË  
AUTORIZUAR (IEKA)

Përafrimi i legjislacionit të vendit tonë me Direktivat e BE-së (acquis communautaire), e veçanërisht përafrimi i ligjeve që lidhen me organizimin e biznesit dhe raportimin financiar, ka si qëllim kryesor vendosjen e rregullave të qarta për kryerjen e biznesit, rritjen e transparencës dhe padryshim, mbrojtjen e interesit publik. Në këtë kuadër, ndryshimet e fundit ligjore kanë përmirësuar ndjeshëm kërkesat, lidhur me përmbajtjen dhe cilësinë e informacioneve financiare që raportohen. Por megjithëse raportet financiare vjetore mbeten ende mënyra kryesore e komunikimit midis enteve të biznesit dhe palëve të interesuara,

rregullatorët dhe mbikëqyrësit në shumë juridiksione në botë kanë shkuar më tej me kërkesat për raportim, duke përfshirë edhe informacione të tjera jo-financiare, një prirje globale kjo që ka filluar të ndihet edhe në vendin tonë.

Hyrja në fuqi këtë vit e ligjit 25/2018: "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ka ndryshuar dukshëm kërkesat për raportim nga entet e biznesit. Përveç raportimit financiar për qëllime të përgjithshme, për një numër entesh bëhen të detyrueshme të hartohen dhe publikohen një seri raportesh të tjera, kryesisht me natyrë jo-financiare, siç janë: raportet për ecurinë e veprimtarisë, ku entet e mëdha dhe ato me interes publik kërkojnë të përfshijnë një raport jo-financiar, që ndihmon për një kuptim më të mirë të ecurisë dhe zhvillimit të entit, të ecurisë së pozicionit të tij financiar, për të vlerësuar ndikimin e veprimtarisë së biznesit në mjedis, për çështjet sociale dhe ato të punësimit, të drejtat e njeriut, korrupsionin, etj. dhe një raport për drejtimin e brendshëm, i cili analizon rregullat/kodet e menaxhimit e të qeverisjes, që zbatohen për drejtimin e brendshëm. Ndryshime të tilla kanë ndikim jo vetëm mbi biznesin, por edhe mbi përdoruesit e informacioneve, ku natyrisht përfshihen edhe bankat. Këto të fundit i përdorin informacionet e biznesit për qëllime të

vendimmarrjes për huadhënie, që u mundëson bizneseve të sigurojnë likuiditetet, si për vijimin e veprimtarisë së tyre në rrjedhën normale të biznesit, ashtu edhe për investimet që do të garantonin ecurinë në vijim.

Gjatë viteve të tranzicionit veprimtaria e shumë enteve të biznesit, është gjendur shpesh përpara dilemës nëse duhet të jetë formale, pjesërisht formale, apo informale. Kjo është e shpjegueshme deri diku nga faktorë, të tillë si: mungesa e traditës së ekonomisë së tregut, dominimi i bizneseve familjare, bizneseve me pronësi nga një, apo pak ortakë/aksionarë, si dhe nga kultura dominuese e moszbatimit të ligjit. Megjithëse qeveritë, sidomos gjatë viteve të fundit, kanë bërë përpjekje të mëdha për formalizimin e ekonomisë, duhet theksuar se rezultatet nuk kanë qenë në nivelin e pritshmërive, për shkak se aksionet e ndërmarra kanë qenë të shkëputura e me fushata, e për më tepër, ato nuk e kanë prekur problemin në thelbin e tij. Për rrjedhojë, ekonomia informale vijon edhe sot të jetë në nivele shqetësuese. Këtë fakt të mirënjohur (ekonominë informale) duket se, për një kohë të gjatë, e kanë pranuar edhe bankat, që në procesin e vlerësimit të tyre, kanë kërkuar që entet e biznesit të paraqesin në aplikimet për hua, jo pasqyrat financiare zyrtare, të

deklaruar me fitime të ulëta në agjencitë përkatëse qeveritare, por pasqyra e raporte të tjera financiare, të njohura në zhargonin e përditshëm si pasqyra "reale", të cilat përmes një paraqitje "të ri-strukturuar", do të paraqisnin një veprimtari të shëndetshme të biznesit, ndryshe nga ajo çka ishte deklaruar zyrtarisht, e që mendohej se do t'ju "garantonte" bankave kthimin e huas, apo përmbushjen e detyrimeve, që lidheshin me produkte të tjera të financimit.

Pavarësisht faktit se, përdorimi i informacioneve financiare (informale), të ndryshme nga ato zyrtare, në të vërtetë ka kontribuar në zhvillimin thelbësor të produktit të huas, nuk mund të anashkalohet dhe ndikimi që kjo praktikë ka pasur në përkeqësimin e cilësisë së huas. Rritja e huave me probleme, paaftësia e bizneseve për të ripaguar në kohë këstet dhe interesat e huas, kanë qenë mjaft shqetësuese për sistemin bankar, çka ka bërë që të rritet shumë vëllimi i punës alternative për saktësimin e të dhënave financiare, në funksion të njohjes më të mirë të situatës financiare të enteve huamarrëse.

Duke i parë të dy këto aspekte nga këndvështrimi i rezultatit final që prodhojnë, nuk ka dyshim se mosvijimi i përdorimit të informacioneve informale ka një efekt pozitiv, në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Ndonëse në këndvështrimin afatshkurtër, nga një veprim i tillë, bankat do të vihen para kufizimit të huadhënies, përdorimi për vlerësimin në vijim vetëm i pasqyrave dhe informacioneve financiare zyrtare, do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së huave dhe do të orientojë më mirë veprimtarinë huadhënëse të bankave. Gjithashtu, kjo do të

lehtësojë punën e strukturave/analistëve të bankave, për të bërë vlerësime sa më realiste dhe do të ndikojë drejtpërdrejt në shmangien e përfshirjes së individëve në praktika korruptive dhe do të pakësojë rrezikun që huat e dhëna të mos kthehen në afat. Nga ana tjetër, ndaj bizneseve do të bëhet presion pozitiv, për të përfshirë në informacionet financiare zyrtare të gjithë efektet e ngjarjeve dhe transaksioneve, duke zbatuar me korrektësi kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, sipas rastit, SKK-të ose SNRF-të.

Nga sa me lart, marrëveshja e vitit të kaluar, midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë, për të mos lejuar përdorimin e pasqyrave financiare jo-formale në procesin e vlerësimit të kërkesave të bizneseve për hua, edhe pse nuk ka fuqi të drejtpërdrejt autoritative, mendoj se është lëvizja e duhur, pasi shërben për të koordinuar më mirë rolet e këtyre institucioneve, në drejtim të zbatimit të kuadrit ligjor e rregullator në fuqi. Ministri i Financave është autoriteti që shpall standardet e raportimit financiar të detyrueshme, për raportimin e informacioneve financiare vjetore. Këto raportime bëhen për qëllime të përgjithshme, e si të tilla, ju shërbejnë shumë përdoruesve. Në këtë kuptim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes strukturave të saj, por dhe agjencive të tyre të varësisë e atyre të pavarura, ka detyrimin të garantojë përdoruesit se informacionet financiare, të përgatitur në pajtim me këto standarde, janë të besueshme dhe se përdoruesit, përfshirë dhe bankat, mund të mbështeten në to për vendimmarrjet e tyre. Edhe Banka e Shqipërisë, në cilësinë e rregullatorit dhe mbikëqyrësit të bankave tregtare, vlerëson të gjithë

procesin e huadhënies, ku padyshim monitorohen dhe vlerësohen tërthorazi edhe pasqyrat financiare që entet e biznesit paraqesin, si pjesë të dokumentacionit për huamarrjen. Zbatimi i kërkesave ligjore, si nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ashtu edhe Banka e Shqipërisë, mendoj se ka ndikim të drejtpërdrejt në formalizimin e biznesit. Në këtë kuadër, bankat do të kenë në vijim, si klientë të tyre, gjithnjë e më shumë biznese të formalizuara, ndërsa nga ana tjetër, bizneset e tjera, duke mbetur jashtë lehtësive të financimit, në kushtet e mungesës së likuiditeteve, do të detyrohen të ndryshojnë sjelljen, duke hartuar informacione që i afrohen sa më shumë realitetit.

Sidoqoftë, procesi i vendimmarrjes për huadhënien është dhe do të vijojë të jetë kompleks dhe do të ishte naive të pretendohet se, mjaftojnë vetëm pasqyrat financiare zyrtare dhe gjithçka gjen zgjidhjen e duhur. Faktikisht, pasqyrat zyrtare janë të domosdoshme, por që procesi të jetë i shëndetshëm dhe të japë ndikim për një zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm duhet që, krahas tyre bankat të bëjnë analiza të thelluara, të përdorin informacione financiare parashikuese, si dhe një mori të dhënash të tjera jo-financiare, të cilat duhet të jenë të kuptueshme, të besueshme dhe të përshtatshme. Në këtë drejtim, një rol të pazëvendësueshëm luan dhe auditi cilësor, që bazohet në standarde teknike cilësore, e që realizohet nga profesionistë të përgatitur, që respektojnë parimet etike dhe praktikat me të mira profesionale. Tani jetojmë në një kohë kur ndryshimet janë të shpejta, kur nuk ka kohë të pritët gjatë në konsolidimin e tyre, pasi të tjera ndryshime bëhen prioritet.

# PSD2 Open Banking:

## Çfarë duhet të dinë bankat!

Procesi i zbatimit të Open Banking do të marrë kohë, por do të krijojë rrethana krejt të reja për bankat. Zbatimi i shpejtë ose jo i këtij procesi do të varet nga rregullatori, por natyrisht edhe nga konsumatori.



### Klodjan HIMA

Drejtor  
DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE TË  
BANKINGUT DIGJITAL FACILIZATION

**D**irektiva e Rishikuar e Shërbimeve të Pagesave (PSD2), e miratuar në tetor 2015, detyron të gjithë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian të zbatojnë këto rregulla si ligj kombëtar, deri në janar 2018. Më 14 shtator 2019, PSD2 Open Banking do të jetë "live" në të gjithë Evropën. Kjo datë do të mbahet mend si fundi i bankingut tradicional dhe fillimi i një epoke të re të bankingut për konsumatorët. PSD2, në mënyrë të pashmangshme, do të sjellë ndryshime në përfitim të konsumatorëve, por ky ndryshim pritet të ndodhë në mënyrë graduale. Data e zbatimit shënon evoluimin e teknologjisë dhe sinjalizon krijimin e një mjedisi më konkurrues, nga i cili do të përfitojnë konsumatorët.

Këta duhet të presin një shërbim më të mirë nga bankat, por ndryshime thelbësore si këto kërkojnë kohë.


### Periudha e Open Banking – Lojtarët e Rinj në Fushën e Shërbimeve Digjitale

PSD2 pasqyron ekonominë e re digjitale dhe rregullorja ka potencialin për të transformuar më tej shërbimet e pagesave dhe sektorin bankar. Jo shumë kohë pas 14 shtatorit, do të shohim ofrues të rinj që do të ofrojnë shërbime, të ashtuquajtura: "Agregim i Llogarive". Këta ofrues, të përcaktuar nga PSD2 si AISP (Ofruesit e Shërbimeve të Informacionit të Llogarisë), do të ofrojnë shërbimet e tyre, të cilat do t'u mundësojnë rezidentëve të BE-së me llogari bankare në disa banka, të marrin të gjitha informacionet e tyre financiare private në një vend të vetëm, pa pasur nevojë të hyjnë në aplikacionet Internet Banking të secilës bankë. Këta ofrues pritet të ofrojnë edhe shërbime të tjera, të tilla si: shërbimet të krahasimit, duke treguar tarifat dhe veçoritë e produkteve të ndryshme të bankave. Rregullorja e re harmonizohet me rritjen e numrit të aplikacioneve mobile dhe rritjen e pagesave "in-app", duke ofruar një opsion pagese të drejtpërdrejt nga llogaria bankare, veçanërisht nëse kjo është më e përshtatshme për përdoruesin. Për shembull, ofruesit e palëve të treta mund të iniciojnë drejtpërdrejt transaksione të tilla si: pagesa e faturave. Nëse konsumatorët do


të përdorin këto shërbime të reja, marrëdhëniet e klientëve me bankat do të ndryshojnë, në mënyrë të pa evitueshme.

### PSD2 – lojtarët e rinj

AISPS (Ofruesit e Shërbimeve të Informacionit të Llogarisë) janë ofruesit që përdorin API-të e institucioneve financiare (të tilla si: bankat) për t'u dhënë përdoruesve informacionin e llogarisë/llogarive të tyre, brenda të njëjtit aplikacion.



PISPS (Ofruesit e Shërbimeve të Inicimit të Pagesave) është një entitet që mund të ketë qasje në të dhënat e llogarisë së klientit dhe mund të iniciojë transaksione, pa marrëveshje paraprake me bankën.



## API-të e Open Banking

Bankat duhet të ofrojnë mundësinë që llogaritet e klientëve të jenë të aksesueshme nëpërmjet përdorimit të Open API-ve, veprimtari kjo e njohur si "Open Banking". Kjo premtion të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme ekosistemin bankar dhe atë të pagesave, duke sjellë sfida për bankat, por gjithashtu duke ofruar mundësi të reja për ata që mund të përshtaten në mënyrë efektive me këto ndryshime.

### Autentifikimi i thelluar dhe menaxhimi i pëlqimit

Në qendër të Open Banking është çështja e "pëlqimit të përdoruesit". Përdoruesit do të kontrollojnë të dhënat e tyre bankare dhe do të jenë në gjendje të zgjedhin se kujt do t'i japin të drejta për t'i aksesuar ato dhe çfarë veprimesh mund të kryejnë. Siguria merr një rëndësi parësore, në kuadrin e një aksesit të tillë në të dhënat bankare. PSD2 përcakton disa standarde teknike rregullative (RTS), ku rëndësi të veçantë ka Autentifikimi i Thelluar i Klientit (SCA-Strong Customer Authentication). Kostoja dhe përgjegjësia për zbatimin e këtyre standardeve teknike do të

bjerë mbi bankat dhe palët e treta do të mbështeten mbi të, si pjesë e Autentifikimit, duke i ridrejtuar konsumatorët në faqet e bankës së tyre, për të bërë autentifikimin. Në këtë kontekst, Autentifikimi i Thelluar i Klientit (SCA) kërkon përdorimin e dy faktorëve të autentifikimit nga tre grupet e mëposhtme:

Diçka që ju e dini: Jepni informacion të veçantë që e di vetëm klienti. P.sh.: fjalëkalimi, përgjigjja ndaj një pyetje sigurie, ose PIN.

Diçka që keni: Disponueshmëria e një pajisje që lidhet vetëm me klientin. P.sh.: identifikimi me dy faktorë, nëpërmjet telefonit celular.

Diçka që je: Tregon prova fizike, p.sh.: të dhëna biometrike, të tilla si: gjurmët e gishtave, ose njohje të fytyrës.

Ndërsa masat e sigurisë shtesë sjellin përfitime të dobishme për konsumatorët dhe institucionet, për tregtarët dhe bankat paraqet një sfidë më vete ofrimi i API-ve, të cilët nuk ndikojnë negativisht përdorimin e shërbimeve nga konsumatorët. Bankat duhet të sigurohen që të dhënat e klientëve janë të sigurta dhe duhet t'u përmbahen udhëzimeve të lëshuara nga klientët për qasjen ndaj

këtyre të dhënave. Bankat, gjithashtu, do të duhet të sigurojnë mundësitë që klientët të mund të revokojnë në çdo kohë pëlqimin që mund t'u kenë dhënë aplikacioneve që shfrytëzojnë Open Banking.

### PSD2 në Shqipëri

Zbatimi i PSD2 për Shqipërinë është një domosdoshmëri, për sa i përket procesit të integritimit në SEPA. Gjithashtu, kjo është edhe kërkesë për Kapitullin 4: "Përputhshmëria e lirë e kapitalit", në marrëveshjen MSA. Grupi i punës i PSD2 në Bankën e Shqipërisë po punon për përshtatjen e PSD2 në legjislacionin shqiptar dhe tashmë ka hartuar një ligj të ri për Shërbimet e Pagesave. Procesi i zbatimit të Open Banking do të marrë kohë, por do të krijojë rrethana krejt të reja për bankat. Zbatimi i shpejtë ose jo i këtij procesi do të varet nga rregullatori, por natyrisht edhe nga konsumatori. Duke pasur parasysh rritjen e vëllimeve të transaksioneve që kryhen sot në internet, ose nëpërmjet telefonave të mençur, Open Banking përbën një pjesë të rëndësishme të tregut, që shumë ofrues të rinj do të nxitojnë ta shfrytëzojnë.

Lista e mëposhtme tregon API-të e detyrueshme, sipas përcaktimit nga Standardi i Grupit të Berlinit<sup>1</sup>.

PËRDORIMI	SHËRBIMI	I Detyrueshëm/Opsional
Inicimi i Një Pagese të vetme	PISP	I Detyrueshëm
Inicimi i Një Pagese të vetme me datë valutë në të ardhmen	PISP	Opsional
Inicimi i Pagesave në Group (Bulk)	PISP	Opsional
Inicimi i Pagesave Periodike	PISP	Opsional
Anulimi i Pagesave	PISP	Opsional
Grupimi i Pagesave për Siglim (Signing Baskets)	PISP/AISP	Opsional
Dhënia e Pëlqimit për Informacionin e Llogarisë	AISP	I Detyrueshëm
Marrja e Listës së Llogarive të Aksesueshme	AISP	Opsional
Marrja e Detajeve të Llogarisë për Listën e Llogarive të Aksesueshme	AISP	I Detyrueshëm
Marrja e Balancës për një Llogari	AISP	I Detyrueshëm
Nxjerrja e Informacionit për Transaksionet të Llogarisë	AISP	I Detyrueshëm
Marrja e Konfirmimit për Disponueshmërinë e Fondeve	PIISP	I Detyrueshëm

<sup>1</sup> Berlin Group është një nismë harmonizimi mbarë-evropiane për standardet e pagesave. Faqja web: <https://www.berlin-group.org>



# Rritja e agrobiznesit, një mundësi e re për rritjen e financimit të sektorit privat nga bankat tregtare



## Gramos OSMANI

Menaxher Ndërhyrjesh, Agrobiznes  
RISI ALBANIA

Agrobiznesi po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendjen e bankave tregtare. Produktet e bimëve medicinale e aromatike (BMA) dhe fruta – perimeve, së bashku, po udhëheqin rritjen e eksporteve shqiptare, duke zënë rreth 42% të totalit të vlerës së eksportit, në kategorinë e ushqimit, pijeve dhe duhanit, si dhe me rritje në vëllime dhe vlerë, nga viti në vit.

Pikërisht bazuar në këtë rritje, që ka potencialin të vazhdojë dhe konsolidohet, nëse sektori kryen investimet e nevojshme strategjike,

Kategoria	Vlera e eksportit sipas viteve (në 000 euro)		
	2016	2017	2018
Fruta dhe Perime të freskëta	63,075	76,383	75,585
Bimë Mjekësore dhe Medicinale	31,580	27,993	32,744
Totali	94,655	104,376	108,329

bankat tregtare kanë përpara një mundësi për shitjen e produkteve të tyre dhe për të forcuar partneritetin me këtë sektor.

### Grumbullimi dhe tharja e bimëve

**medicinale dhe aromatike (BMA).** Në këtë sektor angazhohen rreth 100,000 familje rurale në shkallë vendi, të cilat sigurojnë të ardhurat nga vjelja dhe grumbullimi i BMA-ve. Rreth 95% e prodhimit të përgjithshëm të BMA-ve eksportohet, duke përfaqësuar 20% të vlerës së eksporteve bujqësore të vendit. Zinxhiri i vlerës përbëhet kryesisht nga: 35 shoqëri përpunuese dhe eksportuese në shkallë vendi, prej të cilëve 15 eksportues të mëdhenj; 150 grumbullues lokal në shkallë vendi, prej të cilëve 10 grumbullues rajonalë. Sektori i BMA-ve paraqet kështu mundësi të mëdha për kreditim. Disa prej shoqërive të mëdha, me qëllim rritjen e vlerës së BMA-ve, mbajtjen e standardeve dhe sigurisë së produktit, kanë filluar të investojnë në pajisje për tharjen, transportin, dhe përpunimin e mëtejshëm të bimëve. Potenciali për hua për investime në teknologjinë e tharjes së bimëve nga bankat në këtë sektor llogaritet të jetë të paktën rreth 20 milionë euro. Krahas investimeve në teknologjinë e tharjes pritet të ketë rritje të sipërfaqeve të kultivimit të BMA-ve. Rrjedhimisht mundësia për financim nga bankat ekziston jo vetëm te eksportuesit, por edhe te aktorët e tjerë të zinxhirit të vlerës, siç janë fermerët.

**Sektori i fruta-perimeve.** Fruta – perimet përbëjnë një tjetër sektor strategjik për eksportet shqiptare. Ky sektor përbën rreth 30% të vlerës së eksportit të kategorisë së ushqimit, pijeve dhe duhanit. Pritet që ecuria e sektorit të rritet më tej, pasi ka përpjekje nga eksportues që synojnë të hyjnë në tregjet me vlera më të larta në Evropë. Aktualisht rreth 65% e të ardhurave nga eksporti i perimeve vjen nga eksporti drejt

vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku Kosova dhe Serbia janë konkretisht tregjet që udhëheqin eksportin shqiptar. Gjithsesi, për të pasur qasje në tregjet cilësore të BE-së, është e domosdoshme të sigurohet përputhshmëria me standardet dhe certifikimet përkatëse. Shumica e rrjeteve të mëdha të supermarketeve në Evropë kanë si objektiv të kenë deri në 100% të produkteve të certifikuar në raftet e tyre. Disa prej eksportuesve në Shqipëri kanë nisur procesin e certifikimit Global G.A.P në grup, në bashkëpunim me fermerët e tyre, falë mbështetjes së programit RisiAlbania, i financuar nga Qeveria Zviceriane. Certifikimi Global G.A.P është një standard vullnetar për prodhuesin, që rrit sigurinë e produktit, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit. Ky standard është i krijuar dhe kërkuar nga rrjetet e supermarketeve në Evropë, por marrja e certifikimit nuk është hapi përfundimtar që garanton hapjen dhe mbajtjen e tregjeve me vlerë të lartë. Shumica e shoqërive grumbulluese dhe eksportuese në Shqipëri e kanë të domosdoshme përmirësim e standardeve pas vjeljes. Për arritjen e këtyre standardeve duhet investuar në makineri e pajisje, kryesisht në pastrim, përzgjedhje, paketim dhe transport. Skemat IPARD dhe skema të tjera përbëjnë një mundësi për përballimin e këtyre investimeve, por këtu del dhe roli vital i bankave, për t'i ofruar hua të përshtatshme, kryesisht "bridge loans" të lidhura me IPARD dhe fondet e garancisë për përmirësimin e standardeve. Në total janë rreth 150 grumbullues në të gjithë vendin dhe totali i investimeve të nevojshme është të paktën rreth 50 milionë euro.

# Komunikimi

## Një rikujtesë për audituesit e brendshëm

*Audituesit e brendshëm komunikojnë, jo sepse është pjesë e përshkrimit të punës, por sepse duan të sjellin ndryshimet e duhura në organizatat e tyre. Audituesit e brendshëm zotërojnë aftësitë, njohurinë dhe kapacitetet e duhura, për të qenë këshilltarë të besueshëm, si dhe për të zgjidhur probleme komplekse.*



**Stavri PASHKO**

Auditues i Brendshëm  
VOLVO Group

**N**ë organizata, kur komunikimi ndërpritet, apo shkon në drejtime të gabuara, me siguri që do të ndodhin gjëra aspak të këndshme. Adidas, Pepsi, dhe Yahoo u është dashur të mësojnë në kurrizin e tyre pasojat që mund të sjellë mungesa, apo komunikimi i gabuar. Por, si auditues i brendshëm, nuk mund të mos përmend apo risjell në kujtesë rastin e shoqërisë Enron, ku, midis të tjerash, mungesa e komunikimit të duhur midis ekipit drejtues dhe punonjësve ishte një nga faktorët kyç për rënien brutale të gjigandit të energjisë.

Si auditues të brendshëm, jemi mjaft familjarë me rëndësinë që ka komunikimi në punën tonë. Korniza Globale e Aftësive për Auditin e Brendshëm, një instrument që

përcakton 10 aftësitë thelbësore për të arritur kërkesat e parashtruara nga Kuadri i Praktikave Profesionale Ndërkombëtare, rendit në vendet e para, me të drejtë, edhe komunikimin. Tema e komunikimit shfaqet qartë dhe në vet Standardet Ndërkombëtare të Auditit të Brendshëm. Standardi 2400: "Komunikimi i Rezultateve" jep udhëzime të qarta, duke filluar me detyrimin që: "Audituesit e brendshëm duhet të komunikojnë rezultatet e angazhimeve", duke u pasuar më tej nga standarde të tjera, që trajtojnë Kriteret (2410) dhe Cilësinë e Komunikimit (2420), e duke vazhduar me Shpërndarjen e Rezultateve (2440) të auditit të brendshëm.

Nga përvoja personale, në fillimin e karrierës, kam pasur iluzionin se objektivi i punës i një audituesi të brendshëm është një raport i shkruar mirë, pse jo plot me gjetje dhe i trashë në volum. Praktikues dhe mendues kritikë të profesionit rikujtojnë se produkti final i audituesve të brendshëm nuk është raporti dhe rekomandimet që përmbahen në të, por është vet ndryshimi që sjellin ato. Për të arritur në pikën kur rekomandimet e auditit sjellin ndryshime që mirëprehen nga organizata, sigurisht që duhen pasur parasysh mjaft faktorë dhe punuar në disa drejtime të ndryshme. Për sa i përket komunikimit, mund të konsiderohen dy dimensione kryesore:

(1) Komunikimi Strategjik; dhe

(2) Komunikimi Ndërpersonal i Auditit të Brendshëm.

Komunikimi Strategjik përfshin komunikimin që ndodh midis funksionit të departamentit të auditimit të brendshëm dhe organizatës. Bëhet fjalë për një komunikim të shtrirë përtej komunikimit teknik, që ndodh gjatë angazhimeve të auditit të brendshëm. Synimi i këtij komunikimi është furnizimi i vazhdueshëm me informacion mbi tema, si: misioni dhe strategjia e auditit të brendshëm, promovimi i shërbimeve që ofron auditin e brendshëm dhe kompetencat e aftësitë e skuadrës së audituesve të brendshëm.

Në disiplina të tjera, koncepti i komunikimit strategjik përfshin orkestrimin dhe sinkronizmin e imazheve, veprimeve dhe fjalëve, për të arritur rezultatin e dëshiruar. Në këtë kontekst, ky dimension komunikimi mund të luajë një rol thelbësor në krijimin dhe mbarëvajtjen e imazhit të auditit të brendshëm. Orkestrimi dhe sinkronizmi kërkon kështu angazhimin e një plani të mirëfilltë dhe të përkushtuar komunikimi. Si auditues të brendshëm e dimë mjaft mirë se çfarë është një plan vjetor auditimi. Por, gjatë eksperiencës sime, nuk kam ndeshur në një funksion auditin të brendshëm që të ketë një plan vjetor komunikimi dhe pse të njëjta funksione të auditit të brendshëm kanë pasur ambicien që të njihen në organizatat e tyre si

agjentë ndryshimi, shtues të vlerës, apo këshilltarë të besueshëm. Pa një plan vjetor "Pak dhe saktë". Edhe pse në dukje pak, pikat kyçe mund të përfshijnë mjaft nënpika të tjera, të cilat duhen

jenë të ndërgjegjshëm se janë në komunikim në çdo moment, si me fjalë ashtu dhe me lëvizjet e trupit të tyre, qofshin këto të qëllimshme, apo dhe të pandërgjegjshme. Çdo lëvizje apo veprim komunikon diçka nga ne, ndaj është mirë që të jemi të kujdesshëm që po komunikojmë gjënë e duhur.

Aftësitë komunikuese janë thelbësore në krijimin e një klime bashkëpunimi. Si audituesit, ashtu edhe klientët e tyre duhet të jenë të hapur me njëri tjetrin, në mënyrë që informacioni të rrjedhë pa pengesa midis palëve. Prezantimi i vetes, funksionit që i përkasim, misionit të auditit të brendshëm – bashkangjitur qëllimit të angazhimit të auditimit – nuk janë asnjëherë të tepërta. Sigurisht që të tjerët na njohin dhe kanë dëgjuar për auditimin e brendshëm, por duke qenë të angazhuar vet në procesin e komunikimit, ne mund kontrollojmë më mirë se po komunikohet mesazhi i duhur. Komunikimi është një rrugë me dy korsi, pra një komunikues i mirë është edhe një dëgjues i mirë. Jo rrallë audituesit e brendshëm janë akuzuar (me të drejtë) që u pëlqen të dëgjojnë jehonën e zërit të tyre. Në fakt, atë çka duhet të komunikojmë te grupet tona të interesit nuk është ajo çka ne duam t'u themi, por atë çka ata duhet të dinë, e për të identifikuar qartë nevojat, si fillim duhet të dëgjojmë.

Audituesit e brendshëm komunikojnë, jo sepse është pjesë e përshkrimit të punës, por sepse duan të sjellin ndryshimet e duhura në organizatat e tyre. Audituesit e brendshëm zotërojnë aftësitë, njohurinë dhe kapacitetet e duhura, për të qenë këshilltarë të besueshëm, si dhe për të zgjidhur probleme komplekse. Vetë jemi mjaft të ndërgjegjshëm për këtë; mbetet vetëm që këtë sekret ta ndajmë edhe me të tjerë.

## Një kornizë për planin vjetor të komunikimit



komunikimi, ekziston një rrezik i lartë që kjo ambicie nuk do të kalojë pragun e derës së zyrës së auditit të brendshëm.

Plani i komunikimit është një ushtrim që – i udhëhequr nga drejtuesi – kërkon angazhimin e gjithë funksionit të auditimit të brendshëm, e ndër të tjera, duhet të përpilohet duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

**PSE?** – Çfarë duam të arrijmë me këtë komunikim: duam thjesht informacion? Duam të tjerët të ndjejnë diçka, apo duam të nxisim një veprim? Kush është pozicioni që kemi tani dhe ku duam të shkojmë?

**KUJT?** – Në këtë hap kuptohet audienca të cilës i drejtohem. Persona të ndryshëm kërkojnë mënyra dhe kanale të ndryshme komunikimi.

**ÇFARË?** – Sigurisht që mund të kemi shumë për të komunikuar, por në këtë rast vlen shprehja:

nxjerrë në pah të detajuara mjaft mirë.

**SI dhe KUR?** – Çfarë metodash komunikimi do të përdoren (p.sh.: e-mail, mbledhje, etj.) dhe kur do zbatohen. Këtu është i rëndësishëm edhe koordinimi me të aktorë të tjerë, si p.sh.: departamenti i komunikimit.

Komunikimi Ndërpersonal është dimension i cili – si auditues të brendshëm – jemi mësuar të shohim më shpesh komunikimin me organizatat tona: ai midis audituesit dhe klientit të tyre. Në këtë dimension, vet individit është më tepër i angazhuar. Një auditues i brendshëm duhet të zotërojë aftësi të zhvilluara komunikimi, në të folur dhe të shkruar, për komunikuar me menaxhimin, klientët, apo dhe vet kolegët. Aftësitë e avancuara të komunikimit janë të domosdoshme në çdo hap të procesit të auditimit. Audituesit duhet të

Mirësevini në



Ne jemi gati për  
një fillim të ri.

---

**Po ju?**

# CoCo Bonds

## Obligacionet e veçanta, për situata të veçanta

*Në kontekstin e një krize thelbësore të institucioneve kryesore financiare, apo sistemike, këto obligacione, nëse konvertohen në kohën e duhur, mund të ndihmojnë jo vetëm në parandalimin e falimentimit të institucionit financiar, por dhe të injektojnë kapital, i cili nuk do të mund të merrej ndryshe, brenda një periudhe të shpejtë kohe.*



**Prof. Asoc. Dr. Arbi AGALLIU**

Administrator  
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, UET

### Cfarë janë CoCo Bonds?

CoCo Bonds, është emri teknik i shkurtuar i "Contingent Convertible Bond", që nënkupton një obligacion të konvertueshëm dhe njëkohësisht të kushtëzuar. Ky është një produkt interesant, që ofrohet sot nga sistemi bankar në vendet e zhvilluara. Si çdo obligacion tjetër, ai përfaqëson një instrument me të ardhura fikse, që konvertohet lehtësisht në kapital, sidomos në rast të ndodhjes së ngjarjeve të pazakonta në veprimtarinë financiare të vendit, apo tregjeve financiare.

Konceptimi bazë i këtij produkti u bë nga profesori amerikan Robert Merton i Columbia University, në vitin 1990. Profesor Merton e konceptoi atë si një garanci në dorë të investuesve, nëse do të kishte

kriza financiare në sistem, apo diçka do të trondiste stabilitetin financiar të vendit. Më vonë, ky koncept shërbeu si një nga elementet bazë, që ndihmuan për kapërcimin e krizës financiare globale të viteve 2007 – 2008. Rregullatorët formësuan një instrument të tillë, në prag të shpërthimit të krizës financiare, në përpjekje për t'i lehtësuar qeveritë nga dëmi moral që shkaktuan masat e shpëtimit të bankave me paratë publike. CoCo Bond-i i parë u emetua nga Lloyds në vitin 2009 dhe megjithëse tregu i tyre është i ri dhe i vogël (duke u nisur nga zero), ai është rritur vazhdimisht nga viti në vit e deri një vit më parë vlera e tyre e tregut kaloi 100 miliardë euro. Provën e parë instrumenti e kaloi në vitin 2017 kur Banco Popular Espanol u përthith nga Banco Santander, duke "fshirë" rreth 1.25 miliardë euro CoCo Bonds të së parës.

Si funksionon CoCo Bond? Në kontekstin e një krize thelbësore të institucioneve kryesore financiare, apo sistemike, këto obligacione, nëse konvertohen në kohën e duhur, mund të ndihmojnë jo vetëm në parandalimin e falimentimit të institucionit financiar, por dhe të injektojnë kapital, i cili nuk do të mund të merrej ndryshe, brenda një periudhe të shpejtë kohe. Nga ana tjetër, CoCo Bond-et në vitin 2014 u bënë shumë të njohura, për faktin se ndihmuan bankat në përmbushjen e kërkesave të tyre për kapital, në përmbushje të kërkesave të Bazël

III, të cilat e krahasojnë kapitalin e bankës me aktivet e saj, për të parë nëse veprimtaria e bankës mund të rrezikohet në rast krizash.

Po çfarë e bën të veçantë CoCo Bond-in nga obligacionet e tjera? Për CoCo Bonds-et literatura jep këtë përkufizim: "Dallimi ndërmjet CoCo Bonds dhe obligacioneve të tjera është i lidhur me procesin e konvertimit. Obligacionet (e konvertueshme), në përgjithësi, i sigurojnë mbajtësit mundësinë për ta konvertuar atë në momentin që ai ka dëshirë, ndërkohe që CoCo Bond-i nuk mund të konvertohet në kapital, derisa raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës emetuese bie nën një nivel të caktuar, kur banka detyrohet t'i konvertojë këto obligacione. Nëse raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës bie nën nivelin rregullator, borxhi shndërrohet në aksione të zakonshme."

### Sistemi financiar shqiptar dhe CoCo Bonds

Në këto tre dhjetëvjeçarë tranzicion, përtej ndryshimeve rrënjësore në zhvillimin ekonomik të vendit, në tërësinë e sipërmarrjeve të ndryshme, mund të pohohet fort se ndërmjetësit financiarë janë ata që kanë pasur dhe treguar zhvillimin më të konsiderueshëm dhe serioz, krahasuar me gjithë pjesën tjetër të aktorëve dhe sipërmarrjeve si pjesëmarrëse të tregut. Bankat, si përfaqësuesi më i denjë dhe domethënës i ndërmjetësve

financiarë në Shqipëri, përtej problematikave që gjeneron vet realiteti i tregut shqiptar, përbëjnë një sektor që në tërësinë e tij është i ngjashëm me një sistem bankar të një vendi të zhvilluar. Nga ana tjetër, pjesë e rëndësishme e ndërmjetësve financiarë janë edhe shoqëritë e sigurimeve, të cilat bëjnë përpjekje për t'u zhvilluar dhe për të zhvilluar dita ditës tregun, pavarësisht se deri më tani kultura e sigurimeve vullnetare, ku këto shoqëri tradicionalisht sigurojnë marzhe më të larta fitimi, është ende në nivele të moderuara. Zhvillimi i sektorit bankar, i rregulluar dhe monitoruar rigorozisht nga Banka e Shqipërisë, është i lidhur pazgjidhshmërisht me zhvillimin ekonomik të vendit, kështu që problematikat e ekonomisë kombëtare do të pasqyrohen, në mënyrë të pashmangshme, edhe në ecurinë dhe ritmin e tij. Kushtet ekonomike të tregut dhe konsumatorit shqiptar bëjnë që dhe sistemi bankar të jetë i përqendruar më së shumti në produktet, apo shërbimet tradicionale, si: depozita e hua, apo një sërë shërbimesh të pagesave në funksion të të tretëve.

Në këtë kontekst, niveli i zhvillimit ekonomik dhe kultura modeste financiare e publikut investues në Shqipëri kanë kushtëzuar, deri më sot, një gamë të kufizuar produktesh dhe shërbimesh financiare. Sot, në sistemin bankar shqiptar, nuk është e lehtë të artikulohet mbi produktet derivative, produktet e strukturuar të investimeve në letra me vlerë, etj. Sot fare pak banka kanë emetuar obligacione, ndërkohë që ky treg është ende në fazën e tij të konceptimit dhe të hedhjes së hapave të parë, kryesisht në vendosjen e praktikës funksionale të tregut parësor të emetimit të tyre. Gjithsesi, mund të konstatohet se tashmë ka ardhur koha që edhe bankat tregtare të fillojnë të mendojnë dhe krijojnë produkte

interesante investimi, të cilat do të nxisnin publikun investues shqiptar, individ dhe biznes, të investonin në këto produkte moderne, përtej atyre tradicionale, tashmë prej kohësh në sistem.

Në këtë realitet të zhvillimit të tregut financiar shqiptar, Banka e Shqipërisë, gjatë dy viteve të fundit, po i kushton një vëmendje të veçantë monitorimit dhe mbikëqyrjes së tregut, apo elementëve të cilët do të ndihmojnë rimëkëmbjen e shpejtë, në rast të një krize të mundshme financiare. Në këtë kontekst, CoCo Bond-i vlerësohet si një element interesant. Vihet re se, edhe në tregjet e zhvilluara, të cilat kanë



Megjithëse ka banka në Shqipëri që kanë emetuar obligacione me këto karakteristika, ka ardhur koha që ato, në përgjithësi, ta bëjnë pjesë të strategjisë së tyre rritjen e kapitalit nëpërmjet instrumenteve të tillë, që konvertohen në aksione.



pasur, apo kanë hasur vështirësi të caktuara financiare, futja e produkteve si CoCo Bonds ka bërë që të sigurohet një qarkullim më i shpejtë i kapitalit, duke krijuar prespektiva më të sigurta, në kohë të turbullta të krizave të ndryshme.

Por a ka vend për CoCo Bonds në Shqipëri? Banka e Shqipërisë është orientuar tashmë drejt krijimit të të gjithë prespektivave të sigurta, apo duke ndërtuar skenarë, që janë në funksion të përballimit me sukses të situatave të krizave të ndryshme financiare. Kështu, ngritja pranë Bankës së Shqipërisë e strukturës përkatëse për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka dhe përpjekjet në këtë drejtim, kanë

bërë që emetimi i CoCo Bonds edhe në Shqipëri mund të mos jetë një realitet kaq i largët, me gjithë sfidat e stadi të zhvillimit të tregut financiar shqiptar. Karakteristikat e këtij instrumenti hibrid e bëjnë atë të kërkuar për rritje kapitali, në rast se banka i nënshtrohet procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Ky proces lidhet me ristrukturimin e një banke, e cila përshkak të problemeve të likuiditetit, gërryerjes së kapitalit, apo problemeve të tjera me natyrë specifike, mund të jetë në kushte të paafësisë paguese. Një nga instrumentet që mund të përdoret për ndërhyrje të jashtëzakonshme, apo ristrukturim të një banke, është dhe instrumenti i rikapitalizimit nga brenda, i cili në parim realizon ristrukturimin e bankës nëpërmjet përthithjes së humbjeve nga aksionarët e bankës dhe rritjes së kapitalit, për të plotësuar nivelin rregullator, nëpërmjet konvertimit të obligacioneve në kapital aksionar. Në këto kushte, edhe për bankat shqiptare mund të rekomandohet që të kenë në bilanci të tyre instrumente të tillë, në mënyrë që të jenë të përgatitura dhe të përballojnë me sukses edhe momente vështirësie të veprimtarisë së tyre. Megjithëse ka banka që kanë emetuar obligacione me këto karakteristika, ka ardhur koha që ato, në përgjithësi, ta bëjnë pjesë të strategjisë së tyre rritjen e kapitalit nëpërmjet instrumenteve të tillë, që konvertohen në aksione.

Ashtu siç tregon edhe eksperiencia ndërkombëtare, investues në këto obligacione janë më së shumti investuesit institucionalë, të tillë si: shoqëritë e sigurimit, apo fondet private të pensionit, ndaj zhvillimi i tregut të kapitalit, krahas kapaciteteve institucionale rregullatore, do ndihmonte edhe më tej në jetësimin e një instrumenti të tillë edhe në Shqipëri.

# Standardi 2.0 EMV 3D-Secure

## Blerje të Sigurta Online



**Akil NDRENIKA**

CISO  
PAYLINK

Në shtator të vitit 2019 bëhet efektiv standardi i ri 2.0 EMV 3D-Secure për blerjet e sigurta on line - card not present, për të gjitha transaksionet e kryera online. Markat ndërkombëtare të kartave kanë përgatitur një version të ri të standardit të blerjeve online, të cilin mund ta keni ndeshur deri tani me termat MasterCard SecureCode apo Verified by Visa. Në fakt, version 1.0 kishte hapë në proces të cilat nuk e lehtësonin konsumatorin të kryente blerjet të sigurta online dhe shumë konsumatorë dekurajoheshin, duke lënë blerjen pa e përfunduar. Askush nuk dëshiron një refuzim, e për me tepër, një refuzim jo për shkak të elementeve të sigurisë, të jetësuar për të mbrojtur konsumatorin. Ky refuzim është po aq negativ sa edhe humbjet për

shkak të mashtrimit. Konsumatori por krijon një perceptim të gabuar për kartën, duke mos e përdorur më atë për blerjet online. Refuzime të gabuara (false decline) përllogariten në qindra milion euro në të ardhura të munguara, kryesisht në BE. Blerjet në POS-e në dyqane, butikë, hotele, etj., janë bërë më të sigurta me kalimin e kohës, ndërsa në të njëjtën kohë, mashtrimi online është në rritje. Arsyeja është e thjeshtë dhe lidhet me verifikimin e identitetit të konsumatorit, i cili mbetet një sfidë për konsumatorin dhe tregtarin online. Përllogaritet që rreth 50% e transaksionve online të kenë një rrezik të lartë për vjedhje të identitetit, apo për përdorim keqdashës të kredencialeve.

Tashmë jemi në një pikë kur kemi mjaftueshëm teknologji dhe dije për të larguar çdo shtrëngesë gjatë blerjeve të sigurta online, me standardin 2.0 të EMV 3D-Secure. Ndoshta është kompleks si term, për të shpjeguar diçka shumë të thjeshtë, por ky është një standard i ri në industrinë e kartave, për të siguruar identitetin e konsumatorit në transaksionet digjitale të pagesave online.

Me jetësimin e EMV 3D secure, markat ndërkombëtare të kartave kanë krijuar programet e tyre, të cilesuar si Identity Check. Ky është një program që u mundëson tregtarëve dhe bankave një rrugë të lehtë për të përditësuar dhe zgjeruar sigurinë e tyre, për të vlerësuar drejt rreziqet e mundshme dhe për të siguruar që transaksionet janë aprovuar në mënyrë të sigurt dhe

pa vështirësi për konsumatorin. Duke përdorur Identity Check, inteligjencën artificiale dhe machine learning, standardi EMV 3D Secure versioni 2.0, merr në konsideratë rreth 150 variabla dhe parametra të një transaksioni, për të ndihmuar bankën emetuese të marrë një vendim më të saktë, për të aprovuar një transaksion online, ose për ta refuzuar atë. Këta parametra, apo variabla, përfshijnë faktorë të ndryshëm, si për shembull: gjestikulacioni i caktuar i një konsumatori në smartphone, duke qenë se secili prej nesh ka një model të caktuar gjestesh si e përdor celularin, historiku i blerjeve online, oraret e blerjeve, apo dhe ndriçimi që përdor konsumatori në celular apo kompjuter gjatë blerjeve online. Së bashku me informacione të tjera nga tregtari dhe banka emetuese, këto të dhëna përdoren për të autentikuar një transaksion online. Në rastet kur nevojitet autentikim shtesë, për të mbrojtur konsumatorin, mund të ofrohet identifikimi biometrik, apo me fjalëkalime njëpërdorimësh. Shkurt, version 2.0 ofron një mënyrë më të thjeshtë për të vërtetuar online identitetin e përdoruesit dhe e gjithë kjo ndodh në fraksion të kohës për konsumatorin.

Jetësimi i zgjidhjeve kaq praktike lidhur me sigurinë është kritike për të pasur në vijimësi marrëdhënie besimi trepalëshe mes bankës, tregtarit dhe konsumatorit. Në kohën e ekonomisë digjitale, Identity Check bën të mundur rritjen e besimit dhe konsumatorë të kënaqur.

## OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



### OBJEKTIVI 3

ABI Bank mbështet sërish fushatën: "Së bashku për fjongon rozël!", e cila u çel në muajin mars.

### OBJEKTIVI 11

• Falë investimit të Bankës, në Parkun e Liqenit u përrua "Moli i Dashurisë", i cili rikthen pas shumë vitesh shëtitorja me varka në liqen. Investimi më i ri, është shëtitorja e re buzë liqenit dhe moli të varkave, me e pa vela dhe kanoeve, si një nevojë për ta kthyer zonën në një hapësirë rekreative multifunktionale.

• "100 fshatrat" është bashkëpunimi i fundit i Bankës me Revistën "Bordo". ABI Bank dhe revista "Bordo" janë bërë bashkë për të sjellë më të mirën e këtyre fshatrave. Gjithçka e ilustruar me foto përmes faqeve të dedikuara në revistën e printuar dhe në websitin [www.bordo.al](http://www.bordo.al).

• Banka ishte sponsor i përgjithshëm i Ditës së Verës 2019. Edhe stafi i ABI Bank iu bashkua festës në Sheshin "Skendërbej".

### ART, SPORT, KULTURE

ABI Bank mbështeti:

- Koncertin e kantautorit Ermal Meta, së bashku me një grup instrumentistësh "GnuQuartet",
- Gjyshet milionere në RTSH, spektakli më i ri i kulinarisë dhe humorit,
- "E DIELL" në Top Channel,
- "FAMILJA" në TV KLAN,
- Talk-show-n argëtues e titulluar "Soiree",
- "Makinë me 2 timonë" (M2T), në Radion CLUB FM,
- Radio-Novelën humoristike "Dyqani i Lagjes Sime", në RADIO TIRANA,
- "Hostel by Anabel 2", prodhim i Anabel Entertainment



### OBJEKTIVI 4

• Banka Kombëtare Tregtare, në kuadër të bashkëpunimit me Drejtorinë e Policisë Fier, dhuroi sistemin e mbajtjes së radhës për institucionin. Kjo pajisje pritet të rrisë cilësinë e shërbimeve publike në komunitet.

• Mirëmbajtja dhe aksesin në trashëgiminë tonë kulturore mbështetet çdo ditë mbi punën e palodhshme të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Banka Kombëtare Tregtare, mundësoi dhurimin e kompjuterëve për stafin e DPA, në mbështetje të zhvillimit të mëtejshëm teknologjik të këtij institucioni.

### OBJEKTIVI 6

Banka mbështeti blerjen e materialeve të ndryshme për Forcat e Armatosura Tokësore.



### OBJEKTIVI 3


Credins Bank mbështeti:

- Fondacionin e Fëmijëve Shqiptarë, Dominic Scaglione" për të disatin vit rradhazi.
- Kryqin e Kuq Shqiptar jo vetëm në dhurimin vullnetar të gjakut, por edhe për projektet sociale në ndihmë të fëmijëve jetim, të moshuarve në nevojë.

### OBJEKTIVI 9

Credins Bank:

- Mbështeti Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi" duke mbuluar shpenzimet për blerjen e 15 aparaturave mjekësore për mjediset e kësaj poliklinike si dhe Spitalin Rajonal Shkodër për mbulimin e





shpenzimeve për përmirësimin e infrastrukturës së spitalit.

- Dhuroi pajisje zyre në përmirësimin e kushteve fizike të institucioneve: Fondacioni Firdeus dhe Spitalin Rajonal Vlorë.

- Mbështeti Bashkinë Tiranë në restaurimin e lulishtes dhe këndit të ri të lojërave pranë stadiumit "Arena Kombëtare" në Tiranë.

### OBJEKTIVI 17

- Credins Bank mbështeti ExpoCity në organizimin e AGRO-TECH Expo & Forum 2019.

- Në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ftuan të gjitha studentët, të cilët kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve "Bachelor", të bëheshin pjesë e Programit Kombëtar të Punës. Credins në punën e përditshme, krijon produkte dhe ofron shërbime bankare të cilat orientojnë të rinjtë drejt plotësimit të nevojave të tyre.



Fibank i dhuroi Fondacionit Spitalor "Nënë dhe Fëmija" të gjithë kontributet e mbledhura nga klientët dhe stafi i bankës.

Hapje e degës Unaza e Re! Fibank Albania vijon të rrisë praninë e saj në treg

Viti 2019 filloi me hapjen e një tjetër dege të Fibank në Tiranë. Dega e re ndodhet në zonën e Unazës së Re dhe është kurorëzimi i një pune të palodhur të një ekipi të përkushtuar ndaj suksesit.

Dega Fibank Shkodër - e re në çdo aspekt!  
Rritja e Fibank dhe veçanërisht

zhvillimi i degës në Shkodër, çoi në një instalim modern të zyrave të reja, vendosur në qendër të qytetit. Zyra e re ofron një mjedis më komod, bashkë me një ekip të motivuar dhe të përkushtuar, për të gjithë klientët e interesuar.

Dhuro një lule për Sarandën!  
Fibank përgëzon dhe mbështet në çdo hap nismën e bukur: "Dhuro një lule për Sarandën!"  
Transfertat për këtë kauzë do të jenë të gjitha pa komision!

"Dhuro një lule për Sarandën" është një nismë e ndërmarrë nga të rinjtë e Sarandës, me misionin: "Për një qytet të lulëzuar; Për një angazhim qytetar për t'u marrë shembull; Për një rini që përpiqet t'i japë vendit shpresë; Për përkrahjen e së bukurës, në rrafsh kombëtar".

Produkti i fundit i lançuar nga Fibank Albania është huaja: "Për çdo qëllim", për të gjithë individët, me kushtet më të favorshme të mundshme, të përshtatura ndaj klientit sipas specifikave të tij përkatese. Ky produkt ofron fleksibilitet në planin e investimit dhe synon të mbulojë nevojat financiare të klientëve me të ardhura të qendrueshme, historik të mirë të ripagimit të huas dhe kolateral të pranueshem.

Ambasada Bullgare organizoi pritjen speciale për Ditën Kombëtare të Bullgarisë dhe Fibank si përherë është sponsori kryesor i këtij eventi.



### OBJEKTIVI 1

Në shkurt të 2019-ës, Banka në bashkëpunim me Fondacionin "Fundjavë Ndryshe", u bë pjesë e



donacionit në ndihmë të familjeve në nevojë, të evidentuara në rrethinat e qytetit të Tiranës. Kjo nisimë u mundësua nëpërmjet kontributit vullnetar në kutitë e dhurimit të vendosura në degët e bankës.

#### OBJEKTIVI 4

Në kuadër të edukimit financiar, ICB nëpërmjet kontributit vullnetar të stafit të saj, mirëpriti në mjediset e saj 17 fëmijë të grup moshës 6-7 vjeç, nga Shkolla 9-vjecare jopublike "Arbëria". Fëmijët dëgjuan me vëmendje një prezantim të shkurtër me temë: "Paraja dhe rëndësia e saj", si dhe kryen një vizitë të shkurtër të shoqëruar nga stafi, në disa nga departamentet, për t'u njohur me funksionet kryesore të bankës. Gjithashtu pjesë e veprimtarisë ishte edhe një vizitë në Muzeun e Bankës së Shqipërisë.



#### OBJEKTIVI 3

Bazuar në Ligjin 10237 datë 18.02.2010 dhe VKM 107 9.02.2011: "Për përbërjen rregullat e organizimit dhe të funksionimit për Këshillin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe përfaqësuesit e Punëmarrësve", gjatë muajit mars u zgjodhën 6 kolegë përfaqësues të punëmarrësve, të cilët kanë një mandat 2-vjeçar, me të drejtë rinovimi, si dhe 6 përfaqësues të Punëdhënësit për Këshillin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Ky Këshill është funksional dhe mblidhet disa herë në vit për të përmirësuar në vijim kushtet e punës.

#### OBJEKTIVI 4

Banka është një ndër shoqëritë

që nënshkruan marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, lidhur me Programin Kombëtar të Praktikave të Punës.

#### OBJEKTIVI 5

• Banka ndërmori një fushatë, duke uruar përmes rrjeteve sociale, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas. "Mendo në mënyrë të barabartë, ndërto në mënyrë të zgjuar dhe krijo inovacion për ndryshimin!" ishte tema e përdorur nga UN Women, duke u përqendruar në mënyra të reja inovative, të cilat mund të çojnë përpara çështjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.

• Banka mbështeti këtë vit "Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për Gruan", e organizuar për herë të parë nga UN Women në Shqipëri, me fokus dhunën me bazë gjinore.

#### OBJEKTIVI 8

Intesa Sanpaolo Bank Albania mbështeti AGRO-TECH Panair & Forum si Silver Partner, në datat 15-16 mars pranë mjediseve të Excity.


#### OBJEKTIVI 10

Banka sjell produkte & paketa bankare të dedikuara për Gratë në Biznes. Në një tjetër bashkëpunim të suksesshëm mes Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania, programi u zgjerua në një fazë të dytë me një shumë më të madhe investimi prej 5 milionë euro.



#### OBJEKTIVI 2

Gjatë datave 15-16 mars 2019 në ExpoCity u zhvillua edicioni i dytë



i Agro-Tech Expo & Forum. Për më tepër, në kuadër të Skemave Kombëtare të mbështetura nga Qeveria Shqiptare dhe programit IPARD-like, banka ofron fleksibilitet në garancinë e kërkuar në raste financimi të projekteve të ndryshme. Kjo sigurohet duke ju përfshirë në fondet e garancisë që banka ka me institucionet ndërkombëtare si BERZH dhe Fondin Evropian të Investimeve (EIF).

### OBJEKTIVI 3

Punonjësit e Bankës ProCredit dhuruan gjak, në mbështetje të personave që kanë nevojë për gjak. Kjo nismë erdhi në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar.



### OBJEKTIVI 3

Edhe këtë vit Raiffeisen Bank mbështeti fushatën ndërgjegjësuese: "Lots Of Socks", fushatë e cila bën të mundur mbledhjen e fondeve për shërbimet terapeutike të fëmijëve me Sindromën Down.

### OBJEKTIVI 4

Raiffeisen Bank dha kontributin e saj në organizimin e festimeve për mësuesit në rrethin e Shkodrës, Tepelenë dhe Gjirokastrë, në 7 Mars, "Ditën e Mësuesit".

### OBJEKTIVI 9

Raiffeisen Bank mbështeti për të shtatin vit radhazi veprimtarinë: Albanian ICT Awards.

### OBJEKTIVI 11

Raiffeisen mbështeti Bashkinë Fier në realizimin e projektit: "Ndërtimi i sistemit të konferencës dhe regjistrimit audio në sallën e Këshillit të Bashkisë Fier".

## ART DHE KULTURË

Banka vijoi mbështetjen e saj ndaj Teatrit të Operës dhe Baletit, si partnere e të gjitha shfaqjeve artistike që teatri do organizojë. Teatri e çeli sezonin artistik me premierën e Operës "La Boheme", në datë 16 mars. Gjithashtu, banka vazhdoi partneritetin me Teatrin Kombëtar, ku pjesa e parë e vënë në skenë për këtë vit ishte drama "Gusht: Portret Familjar". Banka mbështeti edhe këtë vit organizimin e Festivalit të Muzikës: "Different Trains". Festivali çel edicionin e tij të tetë në datë 22 mars me koncertin e tij të parë, me pjesëmarrjen e artistëve shqiptarë dhe të huaj të ardhur nga Italia, Gjermania, Franca e Austria. Më pas, në datë 25 mars u organizua koncerti i dytë, i cili mbahet me rastin e Pranverës së Frankofonisë.



Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim organizoi në 12 mars 2019 lançimin e programit GEF - Green Economy Financing Facility, i cili ka për qëllim nxitjen e investimeve në energjinë e gjelbër në Shqipëri.

Për zbatimin e këtij programi në vendin tonë, BERZH ka nënshkruar me Union Bank një hua, me vlerën 6 milionë Euro. Union Bank do të kreditojë individët që dëshirojnë të investojnë në banesat e tyre, duke investuar në projekte që kursejnë energjinë elektrike dhe ulin dukshëm vlerën e faturës së saj. Stafi i rrjetit të degëve Union Bank ka marrë një trajnim të specializuar për trajtimin dhe analizimin e rasteve të huas së programit GEF, të quajtur Kursim+, për ta përcjellë produktin sa më qartë dhe thjesht te klientët.



# JAVA E PARASË

Gjatë javës

**25-31 mars 2019,**

Banka e Shqipërisë (BSh) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe ANFE organizuan veprimtari të larmishme, duke synuar përfshirjen e një numri sa më të madh të rinjsh, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre mbi çështje të edukimit financiar.

Tema e këtij viti: **“Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër!”**

Në Javën e Parasë 2019 u përfshinë aktivisht rreth **4,000 nxënës dhe studentë**, nga më shumë se **90 shkolla** të të gjitha niveleve.

## E hënë, 25 mars 2019

Në mjediset e Bankës së Shqipërisë, u çel Java e Parasë. Veprimtaria u përshëndet nga zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatoe e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Lorena Haxhiu, Zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe z. Silvio Pedrazzi, Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave. Pas fjalëve të rastit, u shpërndanë çmimet për fituesit e konkurseve, të lançuara një muaj më parë nga BSH dhe AAB.

Konkursi i parë, mbante temën: “Mëso. Kurse. Fito” dhe u mbështet nga Banka Kombëtare Tregtare (BKT). Në konkurs morën pjesë nxënës të klasave të VI-ta të shkollave 9-vjeçare.

Konkursi i dytë ishte ai me fotomontazhe me temë: “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër: një 0 më shumë bën diferencën”, në të cilën morën pjesë nxënësit e klasave të IX-ta të shkollave 9-vjeçare. Konkursi u mbështet nga Credins Bank.

Ndërsa konkursi i tretë i organizuar ishte ai i videos më të mirë, për temën: “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër” dhe çmimet u mbështetën nga American Bank of Investments.

Konkursi për esenë më të mirë me temat: “Ridenominimi i Lekut: vështrim socio-linguistik mbi një gabim 55-vjeçar” (Dega Gjuhë-Letërsi) dhe “Ridenominimet: shembuj nga historia dhe rasti shqiptar” (Dega Financë-Bankë), u mbështet nga Intesa Sanpaolo Bank Albania.



**E martë, 26 mars 2019**

**Programi i "Edukimit të Punëkërkesve të Rinj në sektorin bankar"**

Partners Albania, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave, AAB, shpallën hapjen e programit trajnues për punëkërkesit e rinj, për vitin akademik 2019-2020, duke organizuar sesione informimi në universitete.

**Vizita në Muzeun e BSH-së dhe prezantim me temë: "Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër"**

Me rastin e Javës së Parasë 2019, nxënës të klasës së II-të të shkollës "Vatra e Dijes" vizituan Muzeun e Bankës së Shqipërisë. Gjatë vizitës, nxënësit u njohën edhe me temën "Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër".

Gjithashtu, nxënës të shkollës së mesme Hoteleri-Turizëm vizituan Muzeun e Bankës së Shqipërisë, ku u njohën me koleksionin numizmatik, me historinë ekonomike dhe monetare të vendit, si dhe me temën: "Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër".



# JAVA E PARASË

E mërkurë, 27 mars 2019

## Vizitë në Muzeun e BSH-së dhe orë mësimore me temë: “Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër”

Nxënës të shkollës 9-vjeçare jopublike “Don Bosko” vizituan Muzeun e Bankës së Shqipërisë. Fëmijët u njohën me koleksionin numizmatik, si dhe vizituan mjediset e muzeut, dedikuar edukimit financiar të më të vegjëlve.

## Leksioni i hapur në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë

Ekspertë të Bankës së Shqipërisë mbajtën, më 27 mars, një leksion për studentët e viteve të dyta dhe të treta të Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë.

## Vizitë në Muzeun e BSH-së

Në ditën e tretë të Javës së Parasë, nxënës të ciklit të ulët të shkollës 9-vjeçare jopublike “Udha e Shkronjave” vizituan Muzeun e Bankës së Shqipërisë.

## “International Trade Game”

Junior Achievement organizoi tre kampe njëditore rajonale, në Elbasan, Tiranë dhe Durrës. Morën pjesë 90 shkolla të përfaqësuara me rreth 100 nxënës në total. International trade Game është një format edukativ, ku nxënësit në grupe vihen në pozicionin e shteteve dhe operojnë në tregjet ndërkombëtare.





### E enjte, 28 mars 2019

Më 28 mars 2019, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, organizoi për të dytin vit radhazi, **Kuizin Evropian të Parasë**, me pjesëmarrjen e rreth 350 nxënësve të shkollave 9-vjeçare nga i gjithë vendi. Pjesëmarrësit konkurruan në bazë ekipore në një garë të organizuar nëpërmjet platformës online Kahoot!

Fëmijë të moshave 13 – 15 vjeç nga 59 shkolla 9-vjeçare morën pjesë në këtë konkurs, i cili është një nismë e re për të vënë në provë njohuritë e tyre financiare.

Ekipi fitues është nga shkolla 9-vjeçare "Emin Duraku" në Tiranë dhe përbëhet nga: Almira Tota dhe Hana Spahia. Fituesit do të përfaqësojnë Shqipërinë në finalen evropiane, ku do të garojnë 30 vende. Konkursi do të zhvillohet më 7 maj në Bruksel. Përveç kësaj, Banka e Shqipërisë shpërndau dhurata simbolike për fituesit.



**BËHU SI BENI!  
BLI SHTËPINË TËNDE!**



**BENI**

**KREDI  
PËR  
SHTËPI**

Tirana Bank për fushatën e Kredisë për Shtëpi, vjen pranë klientëve të saj dhe publikut të gjerë në një formë e qasje të re, më rinore. Në TVC preket një problem aktual shoqëror, që është përparësia e të pasurit një shtëpi në pronësi ndaj të qenit për një kohë të gjatë me qira. Forma e komunikimit në stilin "Pop culture", duke u bazuar në një MEME të famshme, vjen si risi në tregun bankar dhe në njëfarë mënyre thyen disa standarte klasike, për tu bërë më e prekshme për brezin e ri. I sugjerojmë të gjithë "Të bëjnë si Beni" dhe të blejnë shtëpinë e tyre!

**Kredi për Blerje, Ndërtim  
dhe Rikonstruksion shtëpie.**





# JAVA E PARASË

E premte, 29 mars 2019

## Leksion i hapur në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, nga z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.

Në përfundim të Javës së Parasë, z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, mbajti një leksion të hapur në Universitetin "Aleksandër Moisiu", me temë: "Roli i Bankës së Shqipërisë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit – stabiliteti financiar, një parakusht i domosdoshëm në zhvillimin ekonomik".

## Innovative Talk: "Nga një aplikacion për Financat Personale te Biznesi"

Me rastin e Javës së Parasë, në mjediset e Bankës së Shqipërisë, z. Perjan Duro mbajti prezantimin: "Financat personale: Jeta e një aplikacioni financiar".

Si krijues i aplikacionit MoneyCoach, Perjan Duro prezantoi procesin e krijimit të aplikacionit, me qëllim promovimin e ideve novatore, në funksion të edukimit financiar dhe përfshirjes financiare. Ky aplikacion mund të shkarkohet pa pagesë në Apple dhe Play Store, për të ndihmuar në administrimin e financave personale.



Krijuar nga:



Mbështetur nga:



Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

Western Balkans  
Investment Framework WBIF

Në bashkëpunim me:



# KREDIA Kursim+



TERMO IZOLIM, PANELE DIELLORE DHE SHUMË TË TJERA

GRANT DERI NË

# 20%

TË KREDISË

 **UNIONBANK**  
Banka që dua

Merr tani Kreditinë Kursim+ dhe kurse para deri në 20% të shumës së kredisë së financuar.

## AAB AKTIVITETE

### Takim mbi bashkëpunimin publik – privat për luftimin ndaj krimit në internet

Më 29 janar 2019, Policia e Shtetit, me mbështetjen e Këshillit Evropian dhe në bashkëpunim me AAB-në, organizoi një takim mbi bashkëpunimin publik - privat për luftimin e krimit kompjuterik. Në takim morën pjesë përfaqësues nga: Prokuroria, Krimi Kibernetik dhe Njësitë e Hetimit Financiar në Policinë e Shtetit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, (DPPPP), Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, bankat dhe ISP-të.



### Takim me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, z. Eduard Shalsi

Më 27 shkurt 2019, drejtorët e përgjithshëm të bankave tregtare, u takuan me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, z. Eduard Shalsi. Duke theksuar qëndrueshmërinë, besueshmërinë, zbatueshmërinë ligjore, likuiditetin e bankave dhe domosdoshmërinë e kreditimit të mëtejshëm, të pranishmit në takim ngritën shqetësime në lidhje me efikasitetin e administratës publike, trajtimin fiskal të bankave dhe biznesit, çështjen e të drejtave të pronësisë, de-euroizimit, uljes së cash-it në ekonomi dhe luftës kundër informalitetit, firmës elektronike, vonesave në rimbursimin e detyrimeve nga shteti, të udhëzimit të dy ministrave për tarifat e shërbimit gjyqësor përmbartimor privat, të situatës aktuale, mundësisë për financimin e ekonomisë, etj.



## TRAJNIME

# AAB organizon trajnime

## Tetor - Dhjetor 2018

**Shitja e shërbimeve financiare dhe menaxhimi i marrëdhënieve me klientin** i organizuar më 11-13 shkurt, u drejtua nga Alex Kloos, ekspert i ATTF-së.

**Arbitrazhi Ndërkombëtar: rruga për zgjerimin e biznesit ndërkombëtar** AAB ishte partner mbështetës i Takim-Diskutimit organizuar më 28 shkurt - 1 mars 2019 bashkë me Ambasadën e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri.

**Takim-Diskutimi mbi procesin e fshirjes së huave me probleme dhe ristrukturimin financiar.** Në bashkëpunim me PwC Albania dhe Kosovë, organizoi më 12 mars një seminar ku u ndanë aspekte të ndryshme dhe parashtruan analiza të situatës aktuale.

### Trajnim për zbatimin e mëtejshëm të SNRF 9

AAB, në bashkëpunim me AIIA ofroi më 18-19 mars një seminar dyditor, që ofroi një pasqyrë të plotë të kërkesave të reja të raportimit financiar, të përfshira në SNRF 9, që është bërë i detyrueshëm për periudhat kontabël, që fillojnë më, ose pas 1 janarit 2018.

AAB filloi bashkëpunimin me Institutin Austriak të Ekselencës (AIE), nëpërmjet ofrimit të një sërë trajnimeve në gjuhën shqipe, në rajone të ndryshme të Shqipërisë. Në mars u kryen tre trajnimet e para, lidhur me:

- **"Kapacitetet e shitjes dhe menaxhimi i shitjeve"** organizuar në Fier më 12-13 mars dhe 26-27 mars.
- **"Menaxhimi i konfliktit dhe zgjidhja e problemeve"** organizuar në Lezhë më 19-20 mars.



